



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 94 Akti

Nr. 444 Vendimi

Tiranë, më 16.9.2021

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Genta Tafa (Bungo) Kryesuese

Etleda Çiftja Relatore

Pamela Qirko Anëtare

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Olsida Goxhaj, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Theo Jacobs, në datën 22.7.2020, ora 10:00, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, zhvilloi seancën dëgjimore mbi çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Z. Artan Çupi**, gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Mat.

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE: **Neni 179/b dhe nenet A, Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë**, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar;

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2015, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, komisionere Etleda Çiftja, mori në shqyrtim dhe analizoi provat shkresore të paraqitura nga subjekti për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit kryesisht, dëgjoi subjektin e rivlerësimit, z. Artan Çupi, dhe pasi shqyrtoi në tërësinë e saj çështjen që i përket subjektit të rivlerësimit, i cili në seancën dëgjimore publike kërkoi konfirmimin në detyrë, si dhe bisedoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT PROCEDURALE

1. Z. Artan Çupi është subjekt i rivlerësimit për shkak të funksionit të tij si gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Mat, bazuar në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, ‘Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë’, të ndryshuar” dhe në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim ligji nr. 84/2016).

2. Z. Artan Çupi, bazuar në nenin 14 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit, pas shpërndarjes së çështjes së tij me shortin e datës 15.3.2018, në trupin gjykues të përbërë nga komisionerët Pamela Qirko, Etleda Çiftja dhe Genta Tafa (Bungo).

3. Menjëherë pas hedhjes së shortit u administruan raportet e vlerësimit të hartuara nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI), sipas neneve 31 - 33 të ligjit nr. 84/2016, si dhe nga Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim DSIK), sipas neneve 34 - 39 të ligjit nr. 84/2016.

4. Trupi gjykues i shortuar në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit (në vijim Komisioni), me vendimin nr. 1, datë 15.3.2018, pas studimit të raporteve të sipërpërmendura të vlerësimit, të hartuara nga institucionet shtetërore, vendosi të fillojë hetimin administrativ të thellë dhe të gjithanshëm, sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, si dhe të caktojë kryesuese të trupit gjykues komisioneren Genta Tafa (Bungo). Të gjithë anëtarët deklaruan mosqenien në kushtet e konfliktit të interesit.

5. Trupi gjykues, me vendimin nr. 2, datë 29.5.2020, vendosi: (i) të përfundojë hetimin paraprak për subjektin e rivlerësimit, z. Artan Çupi, bazuar në relatimin mbi rezultatet e hetimit të paraqitur nga relatori i çështjes; (ii) të njoftojë subjektin e rivlerësimit se i ka kaluar barra e provës mbi rezultatet e hetimit, referuar nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, i interpretuar me nenin D të Aneksit të Kushtetutës; (iii) të njoftojë subjektin e rivlerësimit për t’u njohur me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016 dhe me nenet 45 - 47 dhe 35 - 40 të Kodit të Procedurave Administrative; (iv) të njoftojë subjektin e rivlerësimit mbi të drejtat që gëzon nga ligji në lidhje me deklarin e konfliktit të interesit, me të drejtën për të kërkuar marrjen e provave të tjera ose thirrjen e dëshmitarit, si dhe me afatin brenda të cilit mund t’i ushtrojë këto të drejta.

6. Në datën 29.5.2020, përmes postës elektronike¹, trupi gjykues njoftoi subjektin e rivlerësimit mbi: (i) rezultatet e hetimit kryesisht; (ii) kalimin e barrës së provës, sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe të sjellë prova për të provuar të kundërtën, brenda datës 15.6.2020; (iii) njohjen me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016 dhe me nenet 45 - 47 dhe 35 - 40 të Kodit të Procedurave Administrative.

7. Në datën 15.6.2020, subjekti i rivlerësimit, përmes postës elektronike², kërkoi kohë për të paraqitur shpjegimet dhe provat në mbështetje të barrës së provës, kaluar me relacionin mbi rezultatet e hetimit kryesisht.

8. Trupi gjykues, pas shqyrtimit të kërkesës së mësipërme, përmes postës elektronike njoftoi subjektin për dhënien e një afati shtesë prej 5 ditësh për të paraqitur shpjegimet dhe provat brenda datës 22.6.2020, si dhe duke caktuar seancën dëgjimore në datën 26.6.2020.

9. Në datën 22.06.2020 subjekti i rivlerësimit paraqiti shpjegimet e kërkuara në relacionin mbi rezultatet e hetimit kryesisht, së bashku me provat e reja, në mbështetje të barrës së provës.

10. Komisioni, përmes postës elektronike³, njoftoi subjektin e rivlerësimit se seanca dëgjimore e datës 26.6.2020, ora 10:45, do të shtyhej deri në një njoftim të dytë, për shkak të mungesës për shkaqe objektive të njërit prej anëtarëve të trupit gjykues.

11. Në vendimin nr. 3, datë 14.7.2020, trupi gjykues vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit, z. Artan Çupi, në seancë dëgjimore, në përputhje me nenin 55 të ligjit nr. 84/2016. Subjekti i rivlerësimit, në vijim të komunikimit në lidhje me datën dhe orën e ftesës për seancë dëgjimore, e cila nuk u zhvillua në datën 26.6.2020 për arsye objektive, u njoftua përmes postës elektronike⁴ se seanca do të zhvillohej në datën 22.7.2020, ora 10:00, në Pallatin e Koncerteve, kati 0 (*underground*), Tiranë.

12. Bazuar në pikën 2 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues vendosi të përfundojë procesin e rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, z. Artan Çupi, bazuar në të tria kriteret e rivlerësimit: vlerësimi i pasurisë, kontrolli i figurës, si dhe vlerësimi i aftësive profesionale.

II. SEANCA DËGJIMORE

13. Në datën 22.7.2020, ora 10:00, u zhvillua seanca dëgjimore në prani të subjektit të rivlerësimit, si dhe në prani të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Theo Jacobs, në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016. Subjekti i rivlerësimit u paraqit personalisht në seancë.

14. Relatori i çështjes paraqiti rezultatet e arritura nga Komisioni përgjatë fazës së hetimit administrativ, të kryer mbi të tria kriteret e rivlerësimit dhe të kaluara si barrë prove apo për shpjegime.

15. Z. Artan Çupi shprehu qëndrimin e tij pasi dëgjoi relacionin, duke parashtruar shpjegimet përkatëse lidhur me gjetjet e hetimit kryesisht, si dhe mbi procesin e rivlerësimit të kryer ndaj tij.

¹E-mail, datë 29.5.2020, ora 14:40, "Komisioni – njoftim për mbylljen e hetimit kryesisht për procesin tuaj të rivlerësimit".

²E-mail, datë 15.6.2020, ora 9:04, në përgjigje të e-mail-it, "Komisioni – njoftim për mbylljen e hetimit kryesisht për procesin tuaj të rivlerësimit".

³E-mail, datë 22.6.2020, ora 13:32, "Njoftim për shtyrje të datës së zhvillimit të seancës dëgjimore".

⁴E-mail, datë 14.7.2020, ora 15:57, "Njoftim për shtyrje të datës së zhvillimit të seancës dëgjimore".

16. Në seancën dëgjimore të datës 22.7.2020, subjekti i rivlerësimit, z. Artan Çupi, kërkoi konfirmimin në detyrë. Seanca për shpalljen e vendimit u zhvillua në datën 24.7.2020.

17. Në përfundim të seancës së datës 24.7.2020, trupi gjykues, bazuar në pikën 5 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, në bazë të germës “b” të pikës 1 të nenit 58, nenit 44/b, si dhe të pikës 1 të nenit 60 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, me shumicë votash, vendosi: *“Pezullimin nga detyra për një periudhë 1-vjeçare të subjektit të rivlerësimit Artan Çupi, gjyqtar/kryetar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Mat dhe detyrimin e tij për të ndjekur programin e trajnimit, sipas kurrikulave të miratuara nga Shkolla e Magjistraturës”*.

18. Me shkresën nr. *** prot., datë 28.12.2020, vendimi i Komisionit iu dërgua Shkollës së Magjistraturës, me qëllim përgatitjen e programit të trajnimit për subjektin e rivlerësimit.

19. Shkolla e Magjistraturës, me shkresën nr. *** prot., datë 16.7.2021, ka njoftuar Komisionin për rezultatet e provimit përfundimtar të subjektit të rivlerësimit në mbarim të programit të trajnimit, nga ku rezulton përfundimi me sukses i tij, duke mënjanuar mangësitë e konstatuara nga Komisioni.

20. Pas administrimit të këtyre rezultateve, trupi gjykues, i mbledhur në dhomë këshillimi, diskutoi, vlerësoi dhe vendosi të konsiderojë të përfunduar procesin e rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit Artan Çupi.

III. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

21. Subjekti i rivlerësimit, z. Artan Çupi, ka qenë bashkëpunues gjatë gjithë procesit, në përputhje me nenin 48 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI ADMINISTRATIV I KRYER NGA KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

22. Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, është një proces kushtetues, i cili mbështetet në nenin 179/b dhe në Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” sipas krerëve IV, V dhe VI të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”:

- i. ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe për të paraqitur një raport me konstatime në lidhje me vlerësimin pasuror.
- ii. DSIK-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, duke paraqitur në Komision një raport me konstatimin në lidhje me përshtatshmërinë apo papërshtatshmërinë e subjektit të rivlerësimit.
- iii. Këshilli i Lartë i Drejtësisë (tashmë gjyqësor) është organi përkatës i vlerësimit profesional, i cili përgatit një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar pasi përfundon shqyrtimi i dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit dhe përzgjedhja e pesë dokumenteve sipas një sistemi objektiv dhe rastësor.

23. Referuar vendimit nr. 2/2017⁵, të Gjykatës Kushtetuese dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, Komisioni realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, i cili nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

A. RIVLERËSIMI I PASURISË

A/1. Vlerësimi i pasurisë nga ILDKPKI-ja

24. ILDKPKI-ja, me raportin nr. ***, datë 19.1.2018, në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016, ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar pas procedurës së kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit Artan Çupi, i cili është bërë subjekt deklarues në ILDKPKI në vitin 2003, me nr. indeksi ***, në zbatim të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, të ndryshuar, si dhe të ligjit nr. 9367, datë 10.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, të ndryshuar.

25. Subjekti ka dorëzuar deklaratat e interesave private për vitet 2003 - 2016 dhe në datën 25.10.2016, referuar ligjit nr. 84/2016, ka dorëzuar deklaratën e pasurisë së rivlerësimit kalimtar *Vetting*. Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera nga ILDKPKI-ja, për secilën pasuri dhe të ardhur të deklaruar nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur, është konstatuar se:

- *deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;*
- *ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- *nuk ka kryer deklarim të rremë;*
- *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

A/2. Rivlerësimi i pasurisë nga Komisioni

26. Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni hetoi dhe vlerësoi të gjitha faktet dhe rrethanat e nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë: (a) provat e dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI në deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar *Vetting*, të vitit 2017; (b) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja; (c) deklaratat vjetore të deklarimit të pasurisë në ILDKPKI për vitet 2006 – 2016; (ç) provat shkrese/dokumentet të administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (d) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit me anë të komunikimit

⁵Për rrjedhojë, gjykata vlerëson se pretendimi se organet ekzistuese zëvendësojnë organet e reja të rivlerësimit është i pabazuar. Sipas pikës 5, të nenit 179/b, të Kushtetutës, rivlerësimi kryhet nga Komisioni, kurse sipas nenit 4/2 të ligjit nr. 84/2016: “Komisioni dhe Kolegji i Apelit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit”. Pavarësisht formulimit të kësaj dispozite, ajo nuk mund të lexohet në mënyrë të shkëputur, por në harmoni me dispozitat e tjera ligjore që përcaktojnë në mënyrë të detajuar kompetencat e organeve të përfshira në proces, si dhe kompetencat që kryen Komisioni gjatë këtij procesi. Në nenin 5/1 të ligjit nr. 84/2016, parashikohet se: “Procesi i rivlerësimit të subjekteve të rivlerësimit kryhet nga Komisioni, Kolegji i Apelit, Komisionerët Publikë, në bashkëpunim me vëzhguesit ndërkombëtarë”. Po ashtu, siç u përmend edhe më sipër, bazuar në dispozitat e kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezulton se: “Në kryerjen e funksionit të tyre kushtetues organet e rivlerësimit kryejnë një proces të mirëfilltë kontrolli dhe vlerësimi dhe nuk bazohen dhe as janë të detyruara nga përfundimet e paraqitura atyre nga organet e tjera ndihmëse”.

elektronik; si dhe (dh) shpjegimet me shkrim të subjektit të rivlerësimit, e në vijim, deri ditën e seancës dëgjimore, për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

27. Komisioni hetoi në mënyrë të pavarur çdo informacion dhe konkluzion të ILDKPKI-së, ashtu sikurse të gjitha faktet dhe informacionet e marra nga çdo subjekt i së drejtës, në përputhje me ligjin nr. 84/2016, hetim i cili konsistoi në: (i) verifikimin e vërtetësisë së deklarimeve në lidhje me gjendjen pasurore të subjektit dhe të personave të lidhur; (ii) verifikimin e burimeve të krijimit të të ardhurave dhe të shpenzimeve, me qëllim evidentimin e mungesës së mundshme të burimeve të mjaftueshme financiare për të justifikuar pasuritë; (iii) evidentimin e ndonjë fshehjeje të mundshme të sendeve në pronësi ose në përdorim; (iv) evidentimin e ekzistencës së mundshme të deklarimeve të rreme apo të ndonjë konflikti të interesave, të parashikuar në pikën 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.

Personat e lidhur apo të tjerë të lidhur me subjektin e rivlerësimit që janë hetuar

28. Për efekt të procesit të rivlerësimit, janë konsideruar dhe hetuar si persona të lidhur të përfshirë në certifikatën familjare apo të tjerë të lidhur me subjektin e rivlerësimit, shtetasit e mëposhtëm: (1) shtetasja V.Ç., bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit; (2) shtetasi E.Ç., i biri i subjektit të rivlerësimit; (3) shtetasja V.Ç., e bija e subjektit të rivlerësimit; (4) shtetasi I.Ç. (i ati), me cilësinë e personit tjetër të lidhur me subjektin e rivlerësimit, si rezultat i dhënies së huave në shumën 1.300.000 lekë dhe 10.000 euro; (5) shtetasi Nj.Ç. (vëllai), me cilësinë e personit tjetër të lidhur me subjektin e rivlerësimit, si rezultat i dhënies së huas në shumën 700.000 lekë; (6) shtetasja D.Ç. (motra), me cilësinë e personit tjetër të lidhur me subjektin e rivlerësimit, si rezultat i kalimit të shumës prej 85.138 lekësh në menaxhim, në llogarinë bankare të subjektit; (7) shtetasja A.M. me cilësinë e person tjetër të lidhur me subjektin e rivlerësimit, si rezultat i kthimit të huas së marrë nga personi i lidhur/V.Ç., bashkë me interesat në vlerën 50.000 lekë.

Në deklaratën *Vetting* (shtojca 2), të dorëzuar në ILDKPKI në datën 25.1.2017, subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të kanë deklaruar se zotërojnë pasuritë si vijojnë:

29. Apartament banimi me sip. 78,04 m², ndodhur në qytetin e Burrelit, Bashkia Mat

29.1. Në deklaratën *Vetting* 2017 subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se zotëron apartament banimi, blerë sipas kontratës së shitblerjes nr. ***, datë 23.4.2007, në vlerën 2.000.000 lekë. Pjesa takuese: 50%.

29.2. Si burim krijimi subjekti deklaron të ardhurat familjare. Për vërtetimin e deklarimeve të tij, subjekti ka paraqitur dokumentacion ligjor provues⁶.

29.3. Subjekti, në seksionin e të dhënave konfidenciale në deklaratën *Vetting*, në lidhje me burimin e këtij apartamenti, ka deklaruar: *“Për apartamentin e banimit, blerë sipas kontratës nr. ***, datë 23.4.2007, si burim janë përdorur dy shuma, marrë hua nga vëllai dhe babai im, dhe konkretisht 700.000 lekë dhe 1.300.000 lekë (shuma të cilat janë siguruar nga të ardhurat e tyre familjare ndër vite). Këto shuma u shlyen me burim shitjen e apartamentit tim, sipas kontratës nr. ***, datë 21.10.2009, në shumën 1.500.000 lekë dhe nga të ardhurat e mia familjare të krijuara (apartamenti i shitur në datën 21.10.2009 është blerë nga Enti Kombëtar*

⁶Shkresë nr. ***, datë 20.10.2016, e ZVRPP-së Mat; kartelë pasurie; kontratë shitblerjeje nr. ***, datë 23.4.2007; hartë treguese.

i Banesave në datën 20.2.2004, në shumën 515.162 lekë nga të ardhurat)”. Për vërtetimin e deklaratave të tij, subjekti ka paraqitur dokumentacion ligjor provues⁷.

29.4. Nga dokumentacioni i administruar nga ZVRPP-ja Mat⁸ konfirmohet se shtetasit Artan Çupi dhe V.Ç. kanë të regjistruar në bashkëpronësi pasurinë “apartament”, me sip. 78,04 m², me nr. ***, z. k. ***, vol. ***, f. ***, ndodhur në qytetin e Burrelit, Bashkia Mat. Ky apartament është blerë me kontratën e shitjes nr. ***, datë 23.4.2007, në vlerën 2.000.000 lekë, e cila është likuiduar jashtë zyrës noteriale. Referuar praktikës bashkëlidhur rezulton se shitësit e kanë përfituar këtë apartament me anë të privatizimit.

29.5. Nga verifikimi i deklaratave periodike vjetore rezulton se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar në DVP-në e vitit 2007 burimin në lidhje me këtë apartament, ndërsa në DVP-në e vitit 2009 ka deklaruar se ka marrë hua:

- i. shumën 1.300.000 lekë nga babai i tij, për blerje apartamenti, sipas kontratës së huas nr. ***, datë 3.11.2009;
- ii. shumën 700.000 lekë nga vëllai i tij, për blerje apartamenti, sipas kontratës së huas nr. ***, datë 3.11.2009.

29.6. Komisioni, nga analizimi i deklaratave periodike vjetore, konstaton se në DPV-në e vitit 2006 (e plotësuar në datën 15.3.2007) subjekti ka deklaruar si adresë banimi: lagjja “****”, rruga “****”, Burrel. Ndërkohë, rezulton se apartamenti që zotëron aktualisht me sip. 78,04 m², me po këtë adresë banimi, është blerë në datën 23.4.2007, ndërsa në pyetësonin standard dhe në pyetësonin nr. 1 subjekti deklaron se banon në këtë apartament që nga viti 2007.

29.7. Në lidhje me konstatimet e mësipërme, subjektit iu kërkuan shpjegime, sipas këtyre rezultateve:

- i. Ka pasaktësi në deklarimin e DPV-së së vitit 2007, pasi subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar burimin e krijimit të blerjes së këtij apartamenti nga huamarrja tek babai dhe vëllezërit.
- ii. Ka mospërputhje lidhur me deklarimin e subjektit për kohën e blerjes së këtij apartamenti, pasi në DPV-në e vitit 2006 subjekti e deklaroi këtë apartament si adresë banimi, ndërkohë që në kontratat e blerjes dhe deklaratimet e subjekti në deklaratën *Vetting* konfirmohet se ky apartament është blerë në vitin 2007.

29.8. Subjekti i rivlerësimit, pas dërgimit të rezultateve të hetimit, ka sqaruar se *është i vërtetë fakti që ka pasaktësi në deklarimin e DPV-së së vitit 2007, pasi është deklaruar vetëm blerja e këtij apartamenti dhe jo burimi i krijimit, që në fakt, ashtu dhe siç është deklaruar më pas, është blerë nga huaja e dhënë nga babai I.Ç. dhe vëllai Nj.Ç.* Lidhur me këtë pasaktësi, subjekti deklaroi se ka dhënë shpjegime pranë ILDKPKI-së⁹ në datën 9.11.2009, sipas së cilave si burim krijimi për blerjen e apartamentit kanë shërbyer kontrata e huas nr. ***, datë 3.11.2009, hua e marrë nga shtetasi I.Ç. në vlerën 1.300.000 lekë dhe shtetasi Nj.Ç., në vlerën 700.000

⁷Kontratë shitblerjeje nr. ***, datë 21.10.2009; kartelë pasurie, ku vërtetohet se ky apartament ka qenë i regjistruar në vitin 1999 në emër të Entit Kombëtar të Banesave dhe në vitin 2004 në emër të shtetasve Artan dhe V.. kontratë shitjeje apartamenti nr. ***, datë 20.2.2004, vlera: 876.353 lekë.

⁸Shkresë nr. *** prot., datë 11.4.2018, praktika bashkëlidhur.

⁹Subjekti dorëzoi procesverbalin, datë 9.11.2009, të ILDKPKI-së.

lekë, sipas kontratës së huas nr. ***, datë 3.11.2009. Në lidhje me mospërputhjen e deklaramit të adresës së apartamentit të banimit në DPV-në e vitit 2006, subjekti deklaroi se ka filluar të banojë në këtë apartament në vitin 2007. Fakti që këtë adresë e ka deklaruar në DPV-në e vitit 2006 ka të bëjë me një pasaktësi (lapsus), pasi DVP-ja e vitit 2006 është plotësuar në datën 15.3.2007, pra në kohën kur kishte filluar të banonte në këtë apartament dhe gabimisht ka deklaruar këtë adresë¹⁰.

Arsyetimi ligjor në lidhje me provat dhe ligjin e zbatueshëm

29.9. Komisioni, duke pasur parasysh: (i) deklaramet e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë për procesin kalimtar *Vetting*; (ii) raportin e hollësishëm të ILDKPKI-së, deklaratave periodike dhe provave shkresore të administruara nga ILDKPKI-ja; (iii) provat shkresore të administruara nga Komisioni, sipas neneve 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (iv) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ dhe gjatë seancës dëgjimore, arsyeton se subjekti arriti të shpjegojë bindshëm pasaktësitë e konstatuara nga Komisioni. Ky qëndrim i Komisionit bazohet edhe në praktikën e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, për sa i përket pasaktësive në deklaratat periodike vjetore, të cilat nuk mund të përbëjnë shkak për marrjen e masës disiplinore ndaj subjektit. Gjithashtu, rezultoi se subjekti ka qenë i saktë në deklaratën *Vetting*, për sa i përket deklaramit të burimit të këtij apartamenti, i cili përputhet me deklaramet e subjektit në DVP-në e vitit 2009.

A. Në lidhje me analizimin e mjaftueshmërisë dhe ligjshmërisë së burimit të krijimit

Burimi I – lidhur me shumën 1.300.000 lekë, marrë hua nga babai i subjektit

29.9.1. Subjekti ka deklaruar për herë të parë në DPV-në e vitit 2009 hua të marrë nga babai i tij në vlerën 1.300.000 lekë, për blerje apartamenti. Në DPV-në e vitit 2010, subjekti ka deklaruar shlyerjen e plotë të kësaj huaje, pa deklaruar burimin e shlyerjes.

29.9.2. Komisioni, me anë të pyetësorit nr. 1, i kërkoi subjektit të paraqesë dokumentacion ligjor justifikues në lidhje me të ardhurat e ligjshme të babait të tij, kontratën e huas, si dhe të saktësojë mënyrën e pagesës për marrjen dhe kthimin e kësaj huaje.

29.9.3. Në përgjigjen e dërguar¹¹, subjekti ka deklaruar se e ka marrë këtë shumë hua nga babai i tij, duke qenë se dispononte para *cash* dhe i nevojiteshin për një kohë shumë të shkurtër, për të mos humbur mundësinë e blerjes së apartamentit. Në kohën e blerjes së apartamentit subjekti ka deklaruar se ka pasur para në bankë, me afat maturimi njëvjeçar, të cilat nuk mund t'i tërhiqte në momentin e blerjes së apartamentit, pasi humbiste të gjithë interesin në depozitën bankare.

29.9.4. Për të vërtetuar marrjen e huas, subjekti ka paraqitur kontratën e huas nr. ***, datë 3.11.2009, lidhur para noteres S.C., sipas së cilës babai i subjektit i ka dhënë hua këtij të fundit në datën 20.4.2007, shumën prej 1.300.000 lekësh, për blerjen e një apartamenti. Afati i shlyerjes ishte përcaktuar 3 vjet, duke filluar nga data e dhënies, 24.4.2007, deri në datën 20.4.2010. Pas kalimit të këtij afati do të fillonin interesat në masën 3 % në muaj.

¹⁰Në mbështetje të deklarametve të tij, subjekti dorëzoi si provë shkresore proceverbalët e mbajtur datë 23.10.2009 dhe datë 9.11.2009, pranë ILDKPKI-së.

¹¹E-mail, datë 25.11.2019.

29.9.5. Subjekti ka deklaruar se babai i tij ka krijuar të ardhurat nga puna në periudhën 25.11.1953 – 31.8.1998, si drejtor i bankës, dega Burrel, kryetar i degës së financës në ish-ndërmartje shtetërore të ndryshme dhe kooperativa bujqësore, si dhe financier pranë shoqërisë private “***” sh.p.k., Burrel, për periudhën 1.9.1998 – 16.10.1998. Gjithashtu, ka qenë i licencuar si ekspert kontabël, si dhe ka pasur edhe depozitë bankare. Subjekti i rivlerësimit nuk ka dorëzuar informacion mbi të ardhurat e babait për periudhën e punësimit të tij, por vetëm vërtetim për të ardhurat nga pensioni, librezën e punës dhe dëshminë si kontabël i miratuar. Përveç vërtetimit për të ardhurat nga pensioni, dokumentet e dorëzuara nuk përcaktojnë të ardhurat që ka marrë babai i tij, si dhe nuk vërtetohet nëse për to janë paguar apo jo tatimet përkatëse.

29.9.6. Komisioni hetoi lidhur me të ardhurat e babait të subjektit, nga ku rezultoi se:

- i. Drejtorja e Përgjithshme e Tatimeve, me shkresën nr. ***, datë 12.5.2020, informon se pas verifikimeve në sistemin informatik *c@ts*, shtetasi I.Ç. nuk rezulton i regjistruar në organin tatimor me aktivitet privat.
- ii. Dega Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Dibër, me shkresën nr. ***, datë 28.4.2020, sqaron se data e fillimit të pensionit është 16.10.1998 e në vazhdim, sipas vendimit të caktimit të pensionit nr. ***, datë 2.3.1999, të cilin e ka vendosur në dispozicion të Komisionit. Në shkresë nuk jepet informacion për të ardhurat përpara vitit 1998.
- iii. Në shkresën nr. ***, datë 27.12.2019, të dhënat e vëna në dispozicion nga “Raiffeisen Bank” janë: gjendje e depozitës në datën 31.12.1995, në shumën 28.081 lekë; gjendje e depozitës në datën 31.12.1996, në shumën 446.843 lekë; dhe gjendje e depozitës në datën 31.12.1997, në shumën 446.843 lekë. Më tej, “Raiffeisen Bank” në përgjigjen nr. ***, datë 18.4.2020, konfirmon se depozita e shtetasit I.Ç. është çelur në datën 23.2.1995.

29.9.7. Në informacionin e përcjellë nga “Raiffeisen Bank” konstatohet se babai i subjektit të rivlerësimit ka pasur depozita në ish-Bankën e Kursimeve, të cilat në datën 31.12.2004 kanë qenë në shumën 2.400.000 lekë.

Depozitat janë shtuar/pakësuar si në tabelën në vijim:

Viti	Çelje	Depozitime	Tërheqje	Krijim depozite	Maturim depozite	Interesa	Transferta për subjektin	Transferta nga subjekti	Komsione / tatime	Gjendje në fund
2005	2,400,000	1,404,299	2,404,299	1,531,899	-	149,496	-	-	17,020	1,532,476
2006	1,532,476	500,000	1,206,171	1,375,545	2,083,475	51,855	-	-	1,863	876,298
2007	876,298	1,200,000	-	3,613,399	2,414,074	45,304	-	-	1,125	2,120,477
2008	2,120,477	971,249	2,171,349	971,404	2,171,839	51,662	-	-	635	971,404
2009	971,404	2,759,200	1,016,000	2,759,200	1,017,740	46,336	-	-	1,200	2,759,740
2010	2,759,740	-	2,809,558	1,300,000	2,809,555	50,355	-	1,300,000	-	1,300,537
2011	1,300,537	1,111,440	541	2,479,300	1,367,860	67,860	-	-	-	2,479,296
2012	2,479,296	-	1,127,667	638,647	2,566,314	87,014	800,000	-	-	638,643
2013	638,643	-	-	2,069,770	669,770	31,124	-	1,400,000	-	2,069,767
2014	2,069,767	-	-	2,147,262	2,147,262	77,492	-	-	-	2,147,259
2015	2,147,259	-	-	-	2,152,738	5,497	2,152,756	-	-	0

29.9.8. Analiza financiare për dhënie e huas

Përshkrim	1998 - 2004	2005	2006	19.4.2007	TOTAL
+ Të ardhura nga punësimi, periudha 1.9.1998 – 16.10.1998	0				0
+ Të ardhura nga pensioni	858,046	183,888	133,418	50,274	1,225,626

+ Të ardhura nga interesat		149,496	51,577	0	201,073
- Shpenzime jetike	572,592	109,557	109,557	43,518	835,224
- Dhënë hua		0	0	1,300,000	1,300,000
+ Kthim huaja e dhënë		0	0	0	0
- Shtim/pakësim gjendje bankare	1,953,157 ¹²	-867,525	-656,180	0	429,453
Balanca vjetore	-1,667,703	1,091,351	731,618	-1,293,244	- 1,137,978

29.9.9. Në lidhje me analizën financiare:

- i. Nuk janë marrë në konsideratë të ardhurat e babait të subjektit deri në vitin 1997, pasi prej tij nuk është paraqitur dokumentacion provues.
- ii. Nuk janë marrë në konsideratë shumat dhuruar djemve nga i ndjeri I.Ç., përkatësisht 1.665.800 lekë, dhuruar djalit B.Ç., dhe 400.000 lekë dhuruar subjektit të rivlerësimit në kohën e daljes më vete.
- iii. Lidhur me analizën financiare për periudhën 1998 – 19.4.2007, të paraqitur në tabelë, janë konsideruar:
 - të ardhurat nga pensioni për periudhën 1998 – mars 2007, në shumën 1.225.626 lekë;
 - të ardhurat nga interesat bankare, sipas dokumentacionit të përcjellë nga “Raiffeisen Bank”, në shumën 201.073 lekë;
 - shpenzimet jetike të përlllogaritura vetëm për një person për atë periudhë për të cilën është dorëzuar dokumentacion për të ardhurat, në shumën 835.224 lekë.

29.9.10. Në përfundim, Komisioni i kaloi barrën e provës subjektit, si vijon:

- i. Subjekti i rivlerësimit nuk provon burimin e ligjshëm të huas së dhënë nga personi tjetër i lidhur/z. I.Ç., për shumën 1.137.978 lekë.
- ii. Ka pasaktësi në deklarin e DPV-së së viteve 2007 dhe 2008, pasi subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar marrjen e kësaj huaje nga babai në vitin 2007, si dhe nuk ka deklaruar detyrimin ndaj huamarrësit, referuar gërmës “dh”, të nenit 4, të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003.

29.9.11. Subjekti i rivlerësimit, në prapësimet e tij në përgjigje të barrës së provës, në procesverbalin e datës 9.11.2009, pranë ILDKPKI-së, ka shpjeguar se: *“Babai I.Ç. dhe vëllai Nj.Ç. kanë banuar në të njëjtën adresë. I.Ç. aktualisht është pensionist dhe ka punuar deri rreth viteve 2000. Mbas kësaj periudhe është licencuar si kontabël i miratuar dhe ka punuar për rreth disa vite në këtë aktivitet privat. Pra, shuma e dhënë hua rreth 1.300.000 lekë janë kursimet ndër vite të mbledhura si nga puna në shtet, edhe në aktivitet privat. Vëllai Nj.Ç. aktualisht punon në OSSH-në Mat me detyrë magazinier. Përveç këtij punësimi është marrë edhe me aktivitet privat si person fizik, për një periudhë rreth 10 vjet. Pra, shuma e dhënë hua rreth 700.000 lekë janë kursimet ndër vite të mbledhura nga puna dhe aktiviteti i tij privat”.*

29.9.12. Më tej, në shpjegimet e tij, subjekti ka deklaruar se: *“Burimi i ligjshëm i krijimit të të ardhurave të babait tim nuk janë vetëm të ardhurat e krijuara nga ai vetë si rezultat i punësimit*

¹²Shkresë nr. *** prot., datë 27.12.2019, e “Raiffeisen Bank”, gjendje e depozitës në datën 31.12.1997, në vlerën 446.843 lekë, ndërsa pas vitit 1997 nuk ka më të dhëna.

të tij në institucione dhe ndërmarrje shtetërore dhe ish-kooperativa bujqësore, si dhe subjekte private, por janë të ardhura të krijuara ndër vite edhe nga pjesëtarë të trungut familjar ku ai ka qenë kryefamiljar dhe ka administruar, akumuluar dhe menaxhuar të ardhurat e gjithë trungut tonë familjar”¹³. Në lidhje me të ardhurat e realizuara nga babai, subjekti ka deklaruar se nga puna pranë Bankës së Shtetit Shqiptar, dega Burrel, ka pasur pagë mujore në vlerën 3.500 lekë, të cilën e ka pasur në vazhdimësi, deri në vitin 1998. Ka punuar si kuadër në punë të ndryshme të rrethit Mat, për të cilat subjekti ka deklaruar se arriti të provojë marrëdhëniet e tij të punës dhe pozicionet përkatëse, por nuk ka arritur të sigurojë për të gjitha periudhat e punësimit pagën përkatëse, për shkak të mungesës së dokumentacionit.

29.9.13. Lidhur me këtë fakt, ka paraqitur si provë nga Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore të Dibrës pagat referuese që ky institucion përdor në përlllogaritjet e pensionit të pleqërisë, për personat që kanë punuar para viteve 1994, por që nuk ka dokumente për pagën që kanë realizuar ndër vite. Subjekti ka sqaruar se është i vërtetë fakti që ka deklaruar informacion të plotë mbi të ardhurat reale të përfituara prej babait nga pensioni dhe jo pagat që ky i fundit ka fituar për periudhën e punësimit 1953 – 1998¹⁴. Për të marrë një informacion të plotë për pagat e përfituara nga babai përpara vitit 1998 (përpara se të dilte në pension), subjekt ka deklaruar se i është drejtuar disa institucioneve qendrore (arkivave) që disponojnë dokumentacionin financiar mbi të ardhurat që ka përfituar¹⁵.

29.9.14. Subjekti i rivlerësimit, në seancën e datës 22.7.2020, në lidhje me pasaktësitë në deklarime, sqaroi se: *“Lidhur me pasaktësinë e deklaratës së vitit 2007, ku unë si subjekt deklarimi kam deklaruar vetëm faktin e blerjes së apartamentit, pa deklaruar burimin e krijimit, kam dhënë këtë sqarim pranë ILDKPKI-së, në datën 9 nëntor 2009, kur jam thirrur nga inspektorja e lartë Dh.S. për të dhënë shpjegime pikërisht për këtë fakt që është konstatuar. Për këtë janë mbajtur edhe dy procesverbale nga ana e Inspektoratit të Lartë, ku unë kam sqaruar se burim krijimi për blerjen e apartamentit nr. *** që unë banoj, që bëhet fjalë, kanë shërbyer kontratat e huas ose marrja hua nga dy persona të lidhur me mua, i ndjeri babai im I. Ç. dhe vëllai im Nj.Ç., respektivisht babai në vlerën 1.300.000, vëllai 700.000. Duke qenë se ishin prindër dhe vëlla nuk hartova kontratë mes tyre për shkak të besueshmërisë, meqë djali i tyre, dhe thashë njëri prindi dhe tjetri vëllai, kemi pas një jetesë deri në vitin ‘97 së bashku, dhe po me këtë takim, nga ana e ILDKPKI-së m’u kërkua që tashmë, meqë u bë ky deklarim, të paraqiteshin edhe kontratat dhe unë kam paraqitur dhe kontratat e huas me nr. ***, datë 3.11.2009, në vlerën 1.300.000 babait, dhe 700.000 të vëllait. Edhe këto procesverbale që unë*

¹³ Trungu familjar i babait të subjektit, sipas certifikatës familjare të vitit 1974 deri në vitin 1998, kur ka dalë në pension, përbëhej nga: I.Ç. - kryefamiljar, L.Ç. - bashkëshorte, Artan Çupi - i biri, B.Ç. - i biri, Nj.Ç. - i biri, D.Ç. - e bija, V.Ç. - e reja, E.Ç. - nipi, V.Ç. - mbesa, B.Ç. - nipi, A.Ç. - e reja.

¹⁴ Për të përcaktuar të ardhurat për periudhën e punësimit 1953 – 1998, subjekti vuri në dispozicion vetëm librezën e punës, ku pasqyrohet aktiviteti i tij i punës për këtë periudhë (drejtor i bankës, dega Burrel; kryetar i Degës së Financës në ish-ndërmarrje shtetërore të ndryshme; kooperativa bujqësore; financier pranë firmës private “****” sh.p.k., Burrel, për periudhën 1.9.1998 – 16.10.1998; licencë nr. 610, datë 23.3.1999, si kontabël i miratuar).

¹⁵ Drejtuar Agjencisë së Sigurimeve Shoqërore Mat, arkivi, ku ka kërkuar vërtetimin mbi pagat *neto* të përfituara nga z. I.Ç.: (a) Banka e Shtetit, për periudhën 25.10.1953 – 8.12.1958; (b) Ndërmarrja Komunale Burrel, për periudhën 1.1.1963 – 7.9.1968; (c) Ndërmarrja Pyjore Burrel, për periudhën 1.11.1968 — 22.2.1969; (ç) Ndërmarrja SMT-Burrel, për periudhën 1.3.1969 – 1.9.1974; (d) Kooperativa Bujqësore Baz, për periudhën 1.9.1974 — 11.12.1978; (dh) Ndërmarrja Bujqësore Burrel, për periudhën 11.12.1978 – 15.2.1984; (e) Drejtoria e Ujërave Burrel, për periudhën 16.2.1984 – 28.2.1993; (ë) Ndërmarrja e Ujërave Bonifikim, për periudhën 1.3.1993 – 30.4.1993; si dhe (f) Reparti 101/K Burrel (Rezervat e Shtetit), për periudhën 1.5.1993 – 31.8.1998.

i kam paraqitur janë hartuar në ILDKPKI, si dhe i janë paraqitur Komisionit në shpjegimet e mia të dhëna”.

Arsyetimi ligjor në lidhje me provat dhe ligjin e zbatueshëm

30. Komisioni, duke pasur parasysh: (i) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë për procesin kalimtar *Vetting*; (ii) raportin e hollësishëm të ILDKPKI-së, deklaratave periodike dhe provave shkresore të administruara nga ILDKPKI-ja; (iii) provat shkresore të administruara nga Komisioni, sipas neneve 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (iv) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ dhe gjatë seancës dëgjimore, arsyeton se:

Lidhur me analizimin e të ardhurave për të cilat subjekti deklaron se kanë shërbyer në kursimin e shumës 1.300.000 lekë nga babai i tij

a) Të ardhura nga punësimi i babait për periudhën 1953 – 1998

a.1. Subjekti ka dorëzuar dokumentacion justifikues për të ardhurat nga punësimi i babait të tij¹⁶, nga analizimi i të cilit rezultoi se të ardhurat për periudhën 1966 – 1992 kanë qenë në shumën 171.971 lekë dhe për periudhën 1993 – 1998 kanë qenë në shumën 505.313 lekë¹⁷.

a.2. Në lidhje me të ardhurat deri në vitin 1992, Komisioni, bazuar edhe në qëndrimin e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit¹⁸, nuk do t'i përfshijë në analizë financiare.

b) Të ardhura nga punësimi i nënës për periudhën 1968 – 1990 dhe të ardhura nga pensioni për vitin 1990 e në vazhdim

b.1. Subjekti ka dorëzuar dokumentacion justifikues për të ardhurat nga punësimi dhe nga pensioni të nënës së tij¹⁹, nga analizimi i të cilit rezultoi se të ardhurat e nënës për periudhën 1966 – 1992 kanë qenë në shumën 126.356 lekë dhe për periudhën 1993 – mars 2007 kanë qenë në shumën 862.545 lekë. Komisioni vlerëson t'i përfshijë në analizë financiare këto të ardhura, për sa kohë kemi të bëjmë me të ardhurat e nënës, të cilat janë pjesë e buxhetit të familjes së babait të subjektit dhe, rrjedhimisht, janë përdorur për mbulimin e shpenzimeve dhe nevojave të tjera të familjes.

¹⁶ Shkresë kthim përgjigje nr. *** prot., datë 18.6.2020, e DRT-së Dibër; aktverifikimi i vjetërsisë në punë, datë 16.6.2020, para vitit 1994, të ASSH-së Mat; vërtetim datë 21.12.1998, i Degës së Rezervave të Shtetit; vërtetim për bazën e vlerësueshme dhe pagën *neto* mesatare, shoqëria “****” sh.p.k.; shkresë kthim përgjigje nr. *** prot., datë 22.6.2020, e DRSSH-së Dibër; vërtetim për vjetërsi në punë për efekt pensioni; vendim nr. ***, datë 1.11.1968, Komiteti Ekzekutiv K. P. rrethi Mat; shkresë nr. *** prot., datë 31.7.1974, Komiteti Ekzekutiv K. P. rrethi Mat; vërtetim datë 18.6.1998, Banka e Kursimeve, dega Burrel; vendim nr. ***, datë 9.7.1990, i Ndërmarrjes së Ujërave Bonifikim Mat; vërtetim datë 25.10.1998, për bazën e vlerësueshme dhe pagën *neto* mesatare të Degës së Rezervave të Shtetit, Burrel; vërtetim datë 21.12.1998, i Degës së Rezervave të Shtetit, Burrel; urdhër emërimi në punë datë 5.5.1954, të Bankës së Shtetit Shqiptar, dega Burrel; vërtetim datë 16.10.1998, i Degës së Rezervave të Shtetit, Burrel; vërtetim datë 17.6.1998, i Ndërmarrjes së Ujërave Mat; përgjigje e kërkesës për dokumentacion me nr. *** prot., datë 12.6.2020, të Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave; shkresë kthim përgjigje nr. *** prot., datë 5.6.2020, e Bankës së Shqipërisë.

¹⁷ Për vitet 1994, 1995, 1996 dhe 1997 u përllogaritën pagat *neto* sipas legjislacionit në fuqi të kohës.

¹⁸ Vendim nr. 19-2019 (JR), datë 26.7.2019.

¹⁹ Aktverifikimi i vjetërsisë në punë para vitit 1994, datë 16.6.2020, të ASSH-së Mat; shkresë kthim përgjigje nr. *** prot., datë 22.6.2020, e DRSSH-së Dibër, vërtetim për vjetërsi në punë për efekt pensioni; shkresë kthim përgjigje nr. *** prot., datë 15.6.2020, e DRSSH-së Dibër mbi të ardhurat totale të realizuara nga pagesa e pensionit.

c) Të ardhura nga subjekti për periudhën 1980 – 1997 (vit kur është shkëputur nga familja)

c.1. Subjekti i rivlerësimit, në shpjegimet e tij pas kalimit të barrës së provës, ka kërkuar që pagat e tij dhe të bashkëshortes (të deklaruara në deklaratën *Vetting*) të llogariten në shumën e të ardhurave familjare, të administruara nga babai i tij deri në fund të vitit 1997, kur është ndarë nga tringu familjar.

c.2. Lidhur me këtë pretendim, Komisioni mori në analizë të ardhurat e realizuara nga subjekti i rivlerësimit vetëm për periudhën 1980 – 1993, në shumën totale 133.536 lekë (të ndara në 78.493 lekë për vitet 1980 - 1992 dhe 55.043²⁰ lekë për vitin 1993), pasi të ardhurat e subjektit dhe bashkëshortes për periudhën 1994 – 2002 janë konsideruar nga Komisioni si burim për pagesën e kësteve për apartamentin e blerë nga EKB-ja.

c.3. Në lidhje me këto të ardhura, Komisioni vlerëson se nuk mund të përfshihen në analizën financiare të babait të subjektit, për sa kohë janë përfshirë në analizën financiare të subjektit të rivlerësimit për pagesën e kësteve për apartamentin e blerë nga EKB-ja.

d) Të ardhura nga punësimi i bashkëshortes së subjektit për periudhën 1990 - 1997 (vit kur është shkëputur nga familja)

d.1. Sipas arsyetimit në pikën e mësipërme (pika “c”), u morën në analizë të ardhurat për periudhën 1990 – 1993, në shumën 80.614 lekë (të ndara në 41.128 lekë për vitet 1990 - 1992 dhe 39.486 lekë për vitin 1993).

d.2. Në lidhje me këto të ardhura, Komisioni vlerëson se nuk mund të përfshihen në analizën financiare të babait të subjektit, për sa kohë janë përfshirë në analizën financiare të subjektit të rivlerësimit për pagesën e kësteve për apartamentin e blerë nga EKB-ja.

e) Të ardhura nga punësimi i vëllait B.Ç., për periudhat 1982 – 1984 dhe 1987 – 1993 dhe të ardhura nga aktiviteti si person fizik privat “shofer furgoni” dhe në shoqërinë “**” sh.p.k. deri në mars të vitit 2001 (vit kur është ndarë)**

e.1. Subjekti ka dorëzuar dokumentacion justifikues për të ardhurat nga punësimi dhe pensioni i vëllait të tij²¹ B.Ç., nga analizimi i të cilit rezultoi se të ardhurat për periudhën 1982 – 1992 kanë qenë në shumën 44.722 lekë, ndërsa për periudhën 1993 – 1994 nuk ka të dhëna, por subjekti ka deklaruar që ka qenë në periudhë papunësie.

e.2. Lidhur me të ardhurat nga aktiviteti privat dhe si i punësuar pranë shoqërisë “****” sh.p.k. rezulton se të ardhurat për vitin 1994 kanë qenë në shumën 5.120 lekë dhe për vitin 2002 kanë qenë në shumën 94.584 lekë (shkëputur nga familja në vitin 2000).

e.3. Komisioni vlerësoi të mos përfshijë në analizë financiare këto të ardhura si dhe shpenzimet e shtetasit B.Ç.

²⁰ Shuma 52.094 lekë + 2.949 lekë.

²¹ Aktverifikimi i vjetërsisë në punë para vitit 1994, datë 16.6.2020, i ASSH-së Mat; vërtetim për bazën e vlerësueshme person fizik “****”, ASSH Mat; shkresë kthim përgjigje nr. *** prot., datë 9.6.2020, e Zyrës Vendore të Punësimit Mat; vërtetim për vjetërsi në punë për efekt pensioni, nr. ***, ***, datë 15.6.2020, certifikatë familjare.

f) Të ardhura nga punësimi i vëllait Nj.Ç. për periudhën 1986 – 2007, kohë kur është marrë huaja

f.1. Bazuar në hetimin e Komisionit²² dhe në dokumentacionin e dorëzuar nga subjekti²³, për të ardhurat nga punësimi i vëllait Nj.Ç., rezultoi se të ardhurat për periudhën 6.2.1986 – 1.10.1991 kanë qenë në shumën 3.806 lekë dhe për periudhën 1994 – mars 2007 kanë qenë në shumën 2.776.113 lekë.

Viti	Paga <i>neto</i>
1994	65,378
1995	87,366
1996	114,078
1997	130,320
1998	147,193
1999	160,704
2000	164,232
2001	185,995
2002	232,898
2003	329,861
2004	361,706
2005	351,902
2006	343,587
Janar - mars 2007	100,893
Total	2,776,113

f.2. Në lidhje me këto të ardhura, Komisioni vlerësoi të mos i përfshijë në analizën financiare të babait të subjektit, për sa kohë subjekti i ka marrë hua të vëllait Nj.Ç., të cilat janë përfshirë në analizën e tij financiare.

g) Të ardhura nga punësimi i motrës D.Ç. për periudhën gusht 1990 – tetor 1997 dhe të ardhura nga pagesa e papunësisë për periudhën tetor 1997 – tetor 1998

g.1. Subjekti ka dorëzuar dokumentacion justifikues për të ardhurat nga punësimi dhe pagesat për papunësinë të motrës së tij²⁴, nga analizimi i të cilit rezultoi se nuk ka informacion lidhur me të ardhurat e përfituara gjatë periudhës 11.8.1990-31.1.1992, ndërsa të ardhurat për periudhën 1993 – 1998 paraqiten në vijim:

Viti	Paga <i>neto</i>
1993	42,326
1994	55,160
1995	73,475

²² Vërtetim nr. ***, datë 27.5.2020, i OSSHE-së.

²³ Vërtetim nr. ***, datë 27.5.2020, i OSSHE-së.

²⁴ Aktverifikimi i vjetërsisë në punë para vitit 1994, datë 12.6.2020, e ASSH-së Mat; vërtetim për bazën e vlerësueshme dhe pagën *neto* mesatare, Zyra Vendore e Punësimit Mat; shkresë kthim përgjigje nr. *** prot., datë 19.6.2020, e “Raiffeisen Bank”; vërtetim për bazën e vlerësueshme dhe pagën *neto* mesatare, Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor Mat; vërtetim datë 6.4.2010, e “Raiffeisen Bank”.

1996	98,681
1997	77,584
1997	5,733
1998	22,916
Total	375,875

g.2. Në lidhje me këto të ardhura, ato nuk do të përfshihen në analizë financiare të babait të subjektit, për sa kohë subjekti nuk ka arritur të provojë që këto të ardhura kanë shërbyer si burim për kursimet e familjes.

h) Të ardhura nga punësimi i bashkëshortes së vëllait të subjektit, znj. A.Ç., për periudhën gusht 2000 – 2007, kohë kur është marrë huaja

h.1. Subjekti ka dorëzuar dokumentacion justifikues për të ardhurat nga punësimi i bashkëshortes së vëllait²⁵, znj. A.Ç., nga analizimi i të cilit rezultoi se të ardhurat për periudhën 2003 – mars 2007 janë në shumën 643.710 lekë.

Viti	Paga <i>neto</i>
2003	146,825
2004	62,396
2005	141,135
2006	235,315
Janar - mars 2007	58,039
Total	643,710

h.2. Në lidhje me këto të ardhura, ato nuk do të përfshihen në analizën financiare të babait të subjektit, për sa kohë subjekti i ka marrë hua të vëllait Nj.Ç., të cilat janë përfshirë në analizën e tij financiare.

30.1. Komisioni, lidhur me të ardhurat pas vitit 1992, bazuar në shpjegimet e mësipërme, përllogariti të ardhurat dhe shpenzimet, si në tabelën në vijim:

Viti	Të ardhura babai/lekë	Të ardhura nëna/lekë	Total të ardhura	Shpenzime jetike/lekë	Shpenzimet jetike sipas rajonit malor/lekë
1993	-	12,635	12,635	8,339	6,504
1994	67,583	23,460	91,043	60,088	46,868
1995	87,611	32,330	119,941	79,161	61,745
1996	113,249	40,170	153,419	101,256	78,980
1997	118,626	41,250	159,876	105,518	82,304
1998	135,310	49,500	184,810	121,974	95,140
1999	113,143	53,900	167,043	110,248	85,993
2000	123,252	58,388	181,640	181,640	141,679
2001	133,152	70,248	203,400	203,400	158,652
2002	144,042	76,056	220,098	187,788	148,032
2003	157,212	83,064	240,276	187,928	148,032
2004	170,178	89,964	260,142	187,928	148,032

²⁵Vërtetim nr. *** prot., datë 12.4.2010, i Zyrës Vendore të Punësimit Mat.

2005	183,888	97,280	281,186	219,114	171,846
2006	133,418	104,300	237,718	219,114	171,846
Mars 2007	50,274	30,000	80274	68,310	42,961
TOTAL	1,730,939	862,545	2,593,484	2,041,808	1,588,614

30.2. Sa më sipër, vërehet se të ardhurat kanë qenë në shumën 2.593.484 lekë, ndërkohë që shpenzimet jetike përlllogariten në shumën 2.041.808 lekë.

30.3. Nëse do të merren në konsideratë shpenzimet jetike sipas rajonit malor, ato janë në shumën 1.588.614 lekë. Këto shpenzime janë llogaritur duke mbajtur në konsideratë të dhënat që disponon INSTAT-i për rajonin malor për vitet 2002 dhe 2005: (1) shpenzimet jetike për vitet 2002 - 2004 u bazuan në informacionin për vitin 2002 (74.016 lekë/person në vit); (2) shpenzimet jetike për vitet 2005 - 2007 u bazuan në informacionin e vitit 2005 (85.923 lekë/person në vit); (3) për vitet 1993 - 2001 shpenzimet jetike u përlllogaritën në vlerën 78% të shpenzimeve jetike, duke konsideruar se pesha e viteve 2002 dhe 2005 për rajonin malor në raport me vlerën në rang vendi është përkatësisht 79% dhe 78%.

30.4. Sipas pikës 4 të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit, persona të lidhur me të ose persona të tjerë të lidhur, të deklaruar në cilësinë e huadhënësit, kanë detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive të dhëna hua.

30.5 Në referim të kësaj dispozite ligjore, Komisioni konstatoi se subjekti i rivlerësimit përmbushi detyrimin ligjor për të justifikuar burimin e huas prej 1.300.000 lekësh, me të ardhura të ligjshme të personit të lidhur/I.Ç., referuar fakteve dhe rrethanave, si vijojnë:

- i. Në datën 19.4.2007 shtetasi I. Ç. i ka dhënë subjektit të rivlerësimit shumën prej 1.300.000 lekësh.
- ii. Në datën 22.6.2007 babai i subjekti ka depozituar shumën 600.000 lekë në “Raiffeisen Bank”, gjithashtu në datën 24.12.2007 ka depozituar sërish shumën 600.000 lekë në “Raiffeisen Bank”. Komisioni, pasi kreu të gjitha veprimet verifikuese, në përfundim të procesit: (i) nuk u vërtetua asnjë fakt e rrethanë që të lidhë subjektin e rivlerësimit me këto depozitime; si dhe (ii) nuk u administrua asnjë provë që të vërtetojë dyshimet mbi pronësinë apo zotërimin e tij të kësaj depozite.

30.6. Komisioni referuar:

- i. Vendimit nr. 20/2019 (JR), të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit sipas të cilit: “... për sa kohë personat e tjerë të lidhur nuk janë subjekte rivlerësimi, analiza dhe vlerësimi i pasurisë së tyre duhet të bëhet në kufijtë e pasurisë së dhënë hua apo dhuruar dhe sipas një vlerësimi logjik e të arsyeshëm, referuar rasteve konkrete e rrethanave specifike të tyre, përveç rasteve të ekzistencës së dyshimeve për pasuri të fshehura në emër të personave të tjerë të lidhur.”
- ii. Vendimit nr. 15/2019 (JR), të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit sipas të cilit: “... në rastet kur subjekti i rivlerësimit gjendet para situatës së parashikuar nga pika 4 e nenit 32, të ligjit nr. 84/2016, duhet të ketë detyrimin të provojë ligjshmërinë e burimit të krijimit të asaj pasurie, e cila është objekt dhurimi apo huaje, pa u shtrirë ky detyrim mbi të gjitha pasuritë që kanë personat e tjerë të lidhur. Interpretimi në të kundërt i kësaj dispozite

konsiderohet se shkel parimin e proporcionalitetit, pasi e ngarkon subjektin me një barrë përtej asaj që ligjërisht është ngarkuar të mbajë dhe barazon statusin e një shtetasi tjetër, personit tjetër të lidhur, që përgjithësisht nuk ka figuruar të ketë qenë subjekt deklarues, me atë të vetë subjektit të rivlerësimit, një mision që del jashtë qëllimit të ligjit e për më tepër duket edhe i pamundur. Pavarësisht, ky arsyetim në asnjë rast nuk duhet të pengojë organet e rivlerësimit që të hetojnë çdo situatë të dyshuar se personat e tjerë të lidhur mbajnë pasuri të fshehura të subjektit të rivlerësimit, apo se janë përdorur për të fshehur ekzistencën e një marrëdhënieje që të çon në një situatë konflikti interesi të subjektit të rivlerësimit me një person tjetër, dyshim i cili duhet të ngrihet mbi rrethana objektive.”

iii. Si dhe disa vendimeve të Komisionit²⁶,

krijon bindjen se analiza financiare e të ardhurave ligjore të shtetasit I.Ç., që kanë shërbyer si burim për dhënien e huas në vlerën 1.300.000 lekë, duhet të shtrihet brenda periudhës së dhënies së huas, në rastin konkret brenda datës 19.4.2007.

30.7. Nga nxjerrja e llogarive bankare rezulton se babai i subjektit ka tërhequr nga “Raiffeisen Bank”: (i) në datën 30.10.2006, shumën 506.172 lekë; dhe (ii) në datën 22.12.2006, shumën 700.000 lekë, në total në fund të vitit 2006 ka tërhequr shumën 1.206.172 lekë. Deri në datën 19.4.2007 babai i subjektit nuk ka bërë asnjë depozitim apo tërheqje në llogari bankare, si dhe nuk rezulton të ketë blerë ndonjë pasuri të luajtshme apo të paluajtshme, për rrjedhojë, shuma 1.206.172 lekë do të konsiderohet si gjendje *cash* deri në datën 19.4.2007. Babai i subjektit ka përfituar të ardhura nga interesat në shumën 201.073 lekë.

Analiza financiare

Përshkrim	Vitet 1993-2004	Viti 2005	Viti 2006	Datë 19.4.2007	TOTAL
+Të ardhurat e familjes	1,994,323	281,168	237,718	80,274	2,593,484
+Të ardhura nga interesat		149,496	51,577	0	201,073
-Shpenzime jetike	1,535,270	219,114	219,114	68,310	- 2,041,808
-Dhënë hua		0	0	1,300,000	- 1,300,000
Tërheqje bankare deri më 19.4.2007			1,206,172	0	1,206,172
Shuma totale					659,551

30.8. Nga analiza financiare, rezulton se babai i subjektit ka pasur të ardhura të mjaftueshme për dhënien e huas në shumën 1.300.000 lekë.

30.9. Për sa i përket pasaktësive në deklaratat periodike vjetore, Komisioni, në mbështetje të qëndrimit të mbajtur nga Kolegji në çështje të ngjashme, e cila përbën tashmë jurisprudencë të konsoliduar të tij²⁷, vlerëson se një deklaram i pasaktë në deklaramet e mëparshme periodike të interesave nuk mund të konsiderohet se është bërë në kundërshtim me përcaktimin e germës “a”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016, për rrjedhojë, nuk është element i mjaftueshëm

²⁶Vendim nr. 217, datë 5.12.2019; vendim nr. 283, datë 29.7.2020.

²⁷Vendimet nr. 9/2020 (JR), datë 26.6.2020, nr. 16/2020 (JR), datë 13.7.2020 dhe nr. 31/2020 (JR), datë 18.11.2020, të Kolegjit.

për t'u konsideruar si një shkak i vetëm dhe i veçuar që prodhon situatën e deklarimit të pamjaftueshëm, në kuptim të pikës 3, të nenit 61, të këtij ligji. Për më tepër, bazuar në dokumentacionin e depozituar nga subjekti pas kalimit të barrës së provës, rezulton se bazuar në procesverbalin e datave 23.10.2009 dhe 9.11.2009, këto pasaktësi janë korrigjuar prej tij pranë organit përgjegjës të ILDKPKI-së, pasi shkaku i hartimit të kontratave të huas ka qenë pikërisht kërkesa e bërë nga ky institucion, që kanë detyruar subjektin për të hartuar kontratat e huas. Për rrjedhojë, rezulton se subjekti i ka korrigjuar këto pasaktësi dhe për më tepër ka qenë konsistent në deklaratimet e tij, si në vitin 2009 përpara ILDKPKI-së, ashtu edhe në deklaratën *Vetting*, ku si burim për blerjen e apartamentit ka deklaruar huan e marrë nga babai i tij I.Ç., në shumën 1.300.000 lekë dhe nga vëllai i tij.

B. Burimi II – lidhur me huan në vlerën 700.000 lekë, marrë nga vëllai i subjektit

31. Subjekti ka deklaruar marrje huaje në vlerën 700.000 lekë nga vëllai i tij Nj.Ç., personi tjetër i lidhur, për blerje apartamenti, sipas kontratës së huas nr. ***, datë 3.11.2009, por nuk ka dokumentacion ligjor provues. Në DPV-në e vitit 2010 subjekti ka deklaruar shlyerjen e plotë të kësaj huaje, pa cituar burimin.

31.1. Me anë të pyetësorit nr. 1, Komisioni i kërkoi subjektit të paraqesë dokumentacion ligjor justifikues në lidhje me të ardhurat e ligjshme të personit tjetër të lidhur/Nj.Ç., kontratën e huas, si dhe të saktësojë mënyrën e pagesës për marrjen dhe kthimin e kësaj huaje.

31.2. Në përgjigjen e dërguar²⁸, subjekti deklaroi se e ka marrë këtë shumë hua nga i vëllai, duke qenë se dispononte para *cash* dhe i nevojiteshin për një kohë shumë të shkurtër, për të mos humbur mundësinë e blerjes së apartamentit. Në kohën e blerjes së apartamentit subjekti deklaroi se ka pasur para në bankë me afat maturimi njëvjeçar, të cilat nuk mund t'i tërhiqte në momentin e blerjes së apartamentit, pasi humbiste të gjithë interesin në depozitën bankare. Më tej, subjekti ka deklaruar se personi tjetër i lidhur/Nj.Ç. i ka krijuar të ardhurat e tij nëpërmjet punësimit në periudhën 6.6.1986 – 1.10.1991, në ish-Ndërmarrjen Komunale Burrel, si grumbullues dhe normist në degën e planit dhe nga 1.10.1991 e në vazhdim në ish-Ndërmarrjen Elektrike Burrel, KESH sh.a., OSSH sh.a, CEZ Shpërndarje, CEZ Albania dhe tashmë OSHEE Tiranë si magazinier. Subjekti ka deklaruar se personi tjetër i lidhur/Nj.Ç. ka pasur si punë të dytë aktivitetin si “administrator” dhe njëkohësisht ortak me 50% në subjektin privat “****” sh.p.k., me objekt “shitje artikujsh të ndryshëm”, ka në pronësi edhe një njësi me sip. 95 m², me vendndodhje në Mat, e cila i ka shërbyer vëllait të subjektit dhe ortakut të tij A.K. për të kryer aktivitetin privat²⁹. Gjithashtu, ai ka krijuar edhe depozitë bankare në “Intesa Sanpaolo Bank” dhe në Bankën Amerikane. Për vërtetimin e deklaratimeve të tij, subjekti ka paraqitur dokumentacion ligjor provues³⁰.

²⁸E-mail datë 25.11.2019.

²⁹Subjekti ka dorëzuar disa urdhra tërheqjeje në periudha të ndryshme, ku vërtetohet se vëllai i tij ka tërhequr nga ish-Banka e Kursimeve pagesa në çek nga ndërmarrje dhe institucione të ndryshme për shitjen e artikujve të ndryshëm që tregtonte.

³⁰Libreza e punës, vërtetime të lëshuara nga OSHEE-ja, informacion mbi periudhën e punësimit dhe nivelin e pagës *bruto* për periudhat: 1.10.1991 – 4.10.2010, pozicioni “asistent i magazinës”, pagë bazë *bruto* mujore 38.000 lekë, ushqim 10.500 lekë, total të ardhura *bruto* mujore 48.500 lekë; periudha 5.10.2010 – 3.3.2013, pozicioni “magazinier operacional”, pagë bazë *bruto* mujore 48.500 lekë, ushqim 10.500 lekë, total të ardhura *bruto* mujore 59.000 lekë; si dhe periudha 4.3.2013 – aktualisht, pozicioni “magazinier”, pagë bazë *bruto* mujore 51.500 lekë, ushqim 10.500 lekë, total të ardhura *bruto* mujore 62.000 lekë. Në lidhje me depozitat në ish-Bankën Amerikane, subjekti ka dorëzuar dokumentacionin për kreditime në llogarinë e shtetasit Nj.Ç., përkatësisht: në

31.3. Për të vërtetuar marrjen e kësaj huaje, subjekti ka paraqitur kontratën e huas nr. ***, datë 3.11.2009, lidhur para noteres S.C., sipas së cilës huadhënësi, personi tjetër i lidhur/I.Ç., i ka dhënë hua subjektit në datën 20.4.2007 shumën prej 700.000 lekësh, për blerjen e një apartamenti, me afat shlyerjeje 3 vjet, duke filluar nga data e dhënies, 24.4.2007 deri në datën 20.4.2010. Pas kalimit të këtij afati do të fillonin interesat në masën 3% në muaj.

31.4. Komisioni ka konstatuar se në lidhje me punësimin pranë subjektit “***” sh.p.k., subjekti i rivlerësimit ka dorëzuar disa urdhra tërheqjeje në periudha të ndryshme, ku vërtetohet se shtetasi Nj.Ç. ka tërhequr nga ish-Banka e Kursimeve pagesa në çek nga ndërmarrje dhe institucione të ndryshme në shumën 7.645.000 lekë³¹. Sa më sipër, Komisioni vlerëson se personi tjetër i lidhur/Nj.Ç. ka pasur të ardhura të mjaftueshme për të kursyer shumën prej 700.000 lekësh, dhënë subjektit të rivlerësimit në formën e huas për blerjen e apartamentit.

31.5. Në përfundim të hetimit, Komisioni i ka kërkuar subjektit të rivlerësimit të japë shpjegime në lidhje me pasaktësitë në deklarin e DPV-ve të viteve 2007 dhe 2008, pasi nuk ka deklaruar marrjen e kësaj huaje nga i vëllai në vitin 2007, si dhe nuk ka deklaruar detyrimin ndaj huamarrësit, referuar gërmës “dh” të nenit 4 të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003.

31.6. Në seancën e datës 22.7.2021, në lidhje me pasaktësitë në deklarime, subjekti dha sqarimet e përshkruara në pikën 29.9.5 të këtij vendimi.

Arsyetimi ligjor në lidhje me provat dhe ligjin e zbatueshëm

32. Komisioni, duke pasur parasysh: (i) deklarinet e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë për procesin kalimtar *Vetting*; (ii) raportin e hollësishëm të ILDKPKI-së, deklaratave periodike dhe provave shkresore të administruara nga ILDKPKI-ja; (iii) provat shkresore të administruara nga Komisioni, sipas neneve 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (iv) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ dhe gjatë seancës dëgjimore, arsyeton se:

32.1. Komisioni, në kushtet kur vërehet se kjo pasaktësi në deklarin e subjektit të rivlerësimit gjendet në deklarin periodik të interesave, në mbështetje të qëndrimit të mbajtur prej Kolegjit në çështje të ngjashme, e cila përbën tashmë jurisprudencë të konsoliduar të tij³², vlerëson se një deklarin i pasaktë në deklarinet e mëparshme periodike të interesave nuk mund të konsiderohet se është bërë në kundërshtim me përcaktimin e gërmës “a” të pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, për rrjedhojë, nuk është element i mjaftueshëm për t’u konsideruar si një shkak i vetëm dhe i veçuar që prodhon situatën e deklarin të pamjaftueshëm, në kuptim të pikës 3, të nenit 61, të këtij ligji. Për më tepër, bazuar në dokumentacionin e depozituar nga subjekti pas kalimit të barrës së provës, rezulton se bazuar në procesverbalin e datave 23.10.2009 dhe 9.11.2009, këto pasaktësi janë korrigjuar prej tij pranë organit përgjegjës të

datën 2.12.2002, shuma 9.121,61 USD, me përshkrim “pagesë e depozitës suaj në maturim”; në datën 8.2.2002, shuma 1.015.880 lekë, me përshkrim “pagesë e depozitës suaj në maturim”; si dhe në datën 10.2.2003, shuma 659.605 lekë, me përshkrim “pagesë e depozitës suaj në maturim”.

³¹ Në datën 10.10.2002, vlera 100.000 lekë; në datën 26.5.2003, vlera 200.000 lekë; në datën 27.6.2003, vlera 56.000 lekë; në datën 18.7.2003, vlerat 236.000 lekë dhe 2.890.000 lekë; në datën 13.8.2003, vlera 235.000 lekë; në datën 13.9.2003, vlera 148.000 lekë, vlera 1.750.000 lekë; në datën 12.1.2004, vlera 1.900.000 lekë; si dhe në datën 9.6.2004, vlera 130.000 lekë.

³²Vendimet nr. 9/2020 (JR), datë 26.6.2020; nr. 16/2020 (JR), datë 13.7.2020; dhe nr. 31/2020 (JR), datë 18.11.2020, të Kolegjit.

ILDKPKI-së, pasi shkaku i hartimit të kontratave të huas ka qenë pikërisht kërkesa e bërë nga ky institucion, që ka detyruar subjektin për të hartuar kontratat e huas.

32.2. Për rrjedhojë, rezulton se subjekti i ka korrigjuar këto pasaktësi dhe për më tepër ka qenë konsistent në deklaratimet e tij, si në vitin 2009 përpara ILDKPKI-së, ashtu edhe në deklaratën *Vetting*, ku si burim për blerjen e apartament ka deklaruar huan e marrë nga babai i tij I.Ç., në shumën 1.300.000 lekë dhe nga i vëllai në shumën 700.000 lekë.

Në lidhje me shlyerjen e huave

33. Subjekti ka deklaruar se shumën prej 1.300.000 lekësh ia ka kthyer personit tjetër të lidhur/babait I.Ç. në datën 21.1.2010, nëpërmjet bankës. Në dokumentacionin e përcjellë nga “Raiffeisen Bank”, konstatohet se në datën 21.1.2010 është kryer një transfertë në shumën 1.300.000 lekë nga llogaria e subjektit të rivlerësimit në llogarinë e personit tjetër të lidhur/babait.

33.1. Subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar në DPV-në e vitit 2010 burimin e shlyerjes së këtyre shumave të marra hua. Ndërkohë, në seksionin e të dhënave konfidenciale në deklaratën *Vetting*, subjekti ka deklaruar se këto shuma u shlyen me burim shitjen e apartamentit, sipas kontratës nr. ***, datë 21.10.2009, në shumën 1.500.000 lekë dhe nga të ardhurat familjare të krijuara.

33.2. Komisioni kreu analizën financiare për të ardhurat, shpenzimet dhe pasuritë e subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur gjatë vitit 2010, nga ku rezultoi se subjekti dhe personat e lidhur kanë pasur mundësi të kryejnë shlyerjen e huave në shumat 1.300.000 lekë dhe 700.000 lekë.

Viti	2010
PASURITË	-1,781,234
<i>Shtesa/pakësime të likuiditeteve</i>	<i>-1,781,234</i>
DETYRIME	-2,000,000
Kthim huaje vëllait Nj.Ç.	-700,000
Kthim huaje babait I.Ç.	-1,300,000
PASURI NETO	218,766
TË ARDHURA	1,939,524
Të ardhurat nga paga e subjektit	1,365,611
Të ardhura nga paga e bashkëshortes	399,452
Të ardhura nga interesat bankare	174,461
SHPENZIMET	923,445
Shpenzimet jetike	683,100
Shpenzime të fëmijëve gjatë studimeve në Tiranë	49,845
Shpenzime arredimi	120,500
Shpenzime për pushime vjetore	70,000
Balanca e fondeve	797,313

Lidhur me apartamentin e mëparshëm, blerë nga Enti Kombëtar i Banesave

34. Në seksionin e të dhënave konfidenciale në deklaratën *Vetting*, subjekti ka deklaruar se shumat e marra hua u shlyen me burim shitjen e apartamentit të tij në datën 21.10.2009, në shumën 1.500.000 lekë dhe nga të ardhurat familjare të krijuara.

34.1. Nga dokumentacioni i administruar nga ZVRPP-ja Mat³³ konfirmohet se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur/bashkëshortja V.Ç., në datën 25.4.2017, kanë kryer transaksion shitje pasurie nr. ***, vol ***, f. ***, zëri kadastral “apartament” me sip. 57.82 m², në qytetin e Burrelit.

34.2. Referuar praktikës bashkëlidhur, subjekti e ka përfiturar këtë apartament me kontratën e shitjes me pagesë të menjëhershme nr. ***, datë 20.2.2004, lidhur me Entin Kombëtar të Banesave, në vlerën 876.353 lekë.

34.3. Ky apartament është shitur me anë të kontratës nr. ***, datë 21.10.2009, në vlerën 1.500.000 lekë, shumë e cila është likuiduar jashtë zyrës noteriale.

34.4. Në lidhje me përfitimën e kësaj banese - referuar shkresës nr. *** prot., datë 19.11.2019, të Entit Kombëtar të Banesave dhe praktikës bashkëlidhur, rezulton se në bazë të vendimit nr. 27.1.2004, subjekti i rivlerësimit Artan Çupi është regjistruar në listën e të pastrehëve. Në datën 3.4.1995 është lidhur kontrata e përkohshme për shitje apartament banimi, sipas së cilës subjekti, përpara nënshkrimit të kontratës detyrohet të paguajë shumën 80.000 lekë, si paradhënie për banesën që ndërton me Entin Kombëtar të Banesave. Më tej është lidhur kontrata e shitjes me pagesë të menjëhershme në datën 20.2.2004.

34.5. Në lidhje me burimin e krijimit - Komisioni kreu analizën financiare për periudhën e shlyerjeve të blerjes së këtij apartamenti, përkatësisht për periudhën 1994 – 2002, shuma e paguar për EKB-në 80.000 lekë, në datën 3.4.1995 dhe në vitin 2004, shuma e paguar për EKB-në 435.162 lekë, në datën 18.2.2004³⁴. Nga analiza financiare e mëposhtme rezulton se subjekti ka pasur të ardhura të mjaftueshme për blerjen e kësaj pasurie.

Përshkrim	1994 - 2002	2004
Apartament me sip. 57.82 m ² , Burrel (përfiturar me statusin e të pastrehëve)	876,353	
Shtesa/pakësime të likuiditeteve <i>cash</i>	1,000,000	0
Total pasuri	1,876,353	0
Detyrim ndaj EKB-së për apartamentin në Burrel	515,162	
Total detyrime	515,162	0
Të ardhura nga pagat - subjekti	3,420,893	1,031,288
Të ardhura nga pagat - bashkëshortja	564,797	183,604
Të ardhura nga zbritjet e përfituara nga EKB-ja	397,246	0
Total të ardhura	4,382,936	1,214,892
Shpenzime jetese sipas ILDKPKI-së ³⁵	3,107,450	469,320
Shpenzime për pushime vjetore brenda vendit		60,000
Shpenzime për shlyerje detyrimesh EKB	80,000	435,162
Total shpenzime	3,187,450	964,482
Balanca e fondeve (të ardhura-pasuri+detyrime-shpenzime)	-165,705	250,410

³³Shkresë nr. prot. *** datë 11.4.2018, praktika bashkëlidhur.

³⁴Sipas deklaratimeve në deklaratat periodike vjetore, subjekti i rivlerësimit ka pasur gjendje *cash* 1.000.000 lekë, në datën 31.12.2003.

³⁵Shpenzime jetike: (1) periudha 1994 - 1996, 80% e të ardhurave; (2) periudha 1997 - 1999, 4 persona, 5.000 lekë/muaj për person; (3) periudha 2000 - 2001, 4 persona dhe periudha 2002 - 2003, 5 persona, sipas shkresës së ILDKPKI-së.

34.6. Në lidhje me shitjen e këtij apartamenti – në DPV-në e vitit 2008 subjekti deklaroi shitje apartamenti me sip. 57.82 m², në vlerën 1.500.000 lekë. Ndërkohë nga dokumentacioni i administruar nga ASHK-ja Mat³⁶, rezultoi se ky apartament është shitur me anë të kontratës nr. ***, datë 21.10.2009, në vlerën 1.500.000 lekë.

34.7. Komisioni vëren se në lëvizjet e llogarisë së subjektit në “Raiffeisen Bank” konstatohet një depozitim në shumën 1.450.000 lekë, në datën 24.6.2008. Me anë të pyetësorit nr. 1, subjektit iu kërkua të deklarojë burimin e krijimit të kësaj shume, shoqëruar me dokumentacion ligjor justifikues. Në përgjigje të pyetësorit nr. 1³⁷, subjekti deklaroi se kjo lëvizje në llogari ka si burim krijimi shumën e depozituar në bankë pas shitjes me para *cash* të ish-banesës me sip. 57.82 m², në Burrel, banesë në të cilën ka jetuar për periudhën 1998 – 2007.

34.8. Subjekti deklaroi se shitjen e këtij apartamenti e ka deklaruar në DPV-në e vitit 2008. Kontrata e shitjes është përpiluar në vitin 2009. Pra, sipas tij, shitja e banesës në shumën 1.500.000 lekë *de facto* është bërë në vitin 2008 dhe kjo shumë në vlerën 1.450.000 lekë (minus 50.000 lekë) është depozituar në llogarinë e tij në “Raiffeisen Bank” në datën 24.6.2008, të cilën e ka deklaruar në DPV-në e vitit 2008. Në momentin e derdhjes së shumës së mësipërme nga ana e bankës nuk i është kërkuar të deklarojë burimin e kësaj shume.

34.9. Nga faktet e analizuara më lart, Komisioni vlerëson se subjekti ka arritur të shpjegojë mospërputhjet lidhur me periudhën e shitjes së këtij apartamenti, deklaruar në DPV-në e vitit 2008 dhe lidhjen e kontratës së shitjes në vitin 2009.

34.10. Në përfundim konkludohet se nuk lindin dyshime apo paqartësi në lidhje me pasurinë apartament me sip. 78.04 m², të ndodhur në qytetin e Matit. Subjekti ka kryer deklaram të saktë në përputhje me ligjin, si dhe ka burime të ligjshme financiare në lidhje me këtë pasuri.

Automjet tip “Mercedes-Benz”, me targa ***

35. Në deklaratën *Vetting* subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se posedon automjetin tip “Mercedes-Benz”, me targa ***, blerë sipas kontratës nr. ***, datë 1.5.2012, në shumën 10.000 euro. Pjesa takuese: 100%.

35.1. Burimi i krijimit: të ardhurat familjare. Për vërtetimin e deklaramëve të tij, subjekti ka paraqitur dokumentacion ligjor provues³⁸.

35.2. Nga dokumentacioni i administruar nga DRSHTRR-ja³⁹, në ILDKPKI, konfirmohet se subjekti i rivlerësimit ka në pronësi automjetin me targa ***, përfituar me kontratën nr. ***, datë 1.5.2012, me vlerë 10.000 euro⁴⁰.

35.3. Në DPV-në e vitit 2013, subjekti deklaroi likuidimin e kësaj huaje në vlerën 10.000 euro, sipas deklaratës noteriale nr. ***, datë 26.2.2014.

³⁶Shkresë nr. *** prot., datë 23.4.2018.

³⁷E-mail datë 25.11.2019.

³⁸Kontratë shitblerjeje nr. ***, datë 1.5.2012, kontratë shitblerjeje datë 12.3.2012, e automjetit në shtetin gjerman, në vlerën 8.300 euro, nga shitësi B.D.; deklaratë doganore, shuma e paguar 232.812 lekë, leje qarkullimi automjetit me targa ***.

³⁹Shkresat nr. *** prot., datë 11.8.2017 dhe nr. *** prot., datë 29.8.2017.

⁴⁰Subjekti ka dorëzuar në deklaratën *Vetting* kontratën e shitblerjes datë 12.3.2012, të automjetit në shtetin gjerman, në vlerën 8.300 euro, nga shitësi B.D. dhe deklaratën doganore, ku shuma e paguar është 232.812 lekë.

35.4. Në përgjigje të pyetësorit nr. 1⁴¹, subjekti ka dorëzuar kontratën e huas nr. ***, datë 18.4.2012 dhe deklaratën noteriale nr. ***, datës 26.2.2014. Ai deklaroi se në kohën e blerjes së automjetit ka pasur lekë në bankë me afat maturimi 1-vjeçar, të cilat nuk mund t'i tërhiqte pasi humbiste gjithë interesin e lekëve në depozitën bankare.

35.5. Referuar kontratës së huas nr. ***, datë 18.4.2012, huadhënësi, personi tjetër i lidhur/I.Ç., i ka dhënë subjektit të rivlerësimit, jashtë zyrës noteriale, shumën 10.000 euro. Kontrata lidhet deri në datën 31.1.2013, pa interesa, dhe mënyra e shlyerjes së huas do të jetë e menjëhershme. Me tej, me anë të deklaratës noteriale nr. ***, datës 26.2.2014, personi tjetër i lidhur/I.Ç. ka deklaruar se është likuiduar shumta e marrë huas.

35.6. Komisioni kreu analizën financiare për të ardhurat, shpenzimet (konsideruar shpenzime jetike për dy persona) dhe pasuritë për periudhën prill 2007 – maj 2012, nga ku rezultoi se personi tjetër i lidhur/I.Ç. ka pasur mundësi për dhënien e huas.

Përshkrim	Prill 2007 - Prill 2012
Shtesa/pakësime të llogarive bankare	-237,650
Total pasuri	-237,650
Të ardhura nga pensioni - babai	1,239,616
Të ardhura nga pensioni - nëna	725,584
Të ardhura nga interesat	348,937
Kthim huaja në vitin 2010	1,300,000
Total të ardhura	3,614,137
Shpenzime jetike 2 persona	1,579,938
Shpenzime për dhënie huaje	1,400,000
Total shpenzime	2,979,938
Balanca e fondeve (të ardhura-pasuri-shpenzime)	871,849

Analiza e subjektit për kthimin e huas

36. Nga analiza financiare më poshtë rezultoi se subjekti ka pasur të ardhura të mjaftueshme për kthimin e huas në vitin 2013.

Kthimi i huas është kryer me transfertë bankare në datën 23.1.2013 dhe ka si burim shlyerjen e një depozite të krijuar ndër vite.

Viti	2013
PASURITË	-1,449,066
<i>Shtesa / pakësime të likuiditeteve</i>	<i>-1,449,066</i>
DETYRIME	-1,400,000
Kthim huaje babait I.C.	-1,400,000
PASURI NETO	-49,066
TË ARDHURA	2,058,685
Të ardhurat nga paga e subjektit	1,378,509
Të ardhura nga paga e bashkëshortes	544,730
Të ardhura nga interesat bankare	135,446
SHPENZIMET	1,412,364
Shpenzimet jetike	705,120

⁴¹ E-mail datë 25.11.2019.

Shpenzime fëmijët gjatë studimeve në Tiranë	146,232
Shpenzim arredime	120,500
Shpenzime për pushime vjetore	80,000
Shpenzime sipas sistemit <i>TIMS</i>	354,032
Shpenzime për automjet primi sipas AMF-së	6,480
Balanca e Fondeve	695,388

36.1. Në DPV-në e vitit 2012, në seksionin “detyrime financiare”, subjekti deklaroi marrje huaje nga huadhënësi I.Ç. (babai), sipas kontratës së huas nr. ***, datë 18.4.2012, në shumën 10.000 euro për blerjen e një automjeti. Ndërkohë në deklaratën *Vetting*, si burim krijimi për këtë automjet deklaroi të ardhurat familjare.

36.2. Nga faktet e analizuara, Komisioni, në përfundim të hetimit, i kërkoi subjektit të paraqesë shpjegime të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit lidhur me mospërputhjet në deklarimin e burimit të të ardhurave që kanë shërbyer për blerjen e këtij automjeti, pasi në deklaratën *Vetting* subjekti deklaroi se si burim kanë shërbyer të ardhurat familjare, ndërkohë që në DPV-në e vitit 2012, në seksionin “detyrime financiare”, subjekti deklaroi se si burim ka shërbyer marrja e një huaje në shumën 10.000 euro nga babai i tij.

36.3. Subjekti i rivlerësimit, pas dërgimit të rezultateve të hetimit, shpjegoi se në deklarimin e bërë në DPV-në e vitit 2012 ka deklaruar marrje huaje nga huadhënësi I.Ç., sipas kontratës së huas nr. ***, datë 18.4.2012, në shumën 10.000 euro, për blerjen e një automjeti. Në deklarimin e bërë në DVP-në e vitit 2013 ka deklaruar likuidimin e kontratës së huas nr. ***, datë 18.4.2012, në shumën 10.000 euro, marrë për blerjen e këtij automjeti. Subjekti deklaroi se pas likuidimit rezulton se ky automjet tashmë është blerë nga të ardhurat e tij. Në deklaratën *Vetting* ka deklaruar si burim të ardhurat familjare, duke pasur parasysh se huaja ishte marrë provizorisht dhe ishte bërë likuidimi i saj, pra në momentin e deklarimit në deklaratën *Vetting* automjeti, përfundimisht, rezulton pasuri e subjektit, ku burim të ardhurash për blerje ishin të ardhurat familjare.

Arsyetimi ligjor në lidhje me provat dhe ligjin e zbatueshëm

37. Komisioni, duke pasur parasysh: (i) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë për procesin kalimtar *Vetting*; (ii) raportin e hollësishëm të ILDKPKI-së, deklaratat periodike dhe provat shkresore të administruara nga ky institucion; (iii) provat shkresore të administruara nga Komisioni sipas neneve 49 dhe 50, të ligjit nr. 84/2016; (iv) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ dhe gjatë seancës dëgjimore, arsyeton se subjekti arriti të shpjegojë bindshëm mospërputhjet e konstatuara gjatë hetimit.

37.1. Duke qenë se në deklaratimet e tij gjatë hetimit administrativ në Komision, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se *huan ia ka marrë babait të tij në vitin 2012 për shkak se kishte para në bankë me afat maturimi 1-vjeçar dhe ia ka shlyer në vitin 2013 dhe, pas likuidimit të huas, rezulton se ky automjet tashmë është blerë nga të ardhurat e tij, trupi gjykues vlerëson se huaja prej 10.000 euro është marrë nga subjekti me qëllim blerjen e automjetit, duke shërbyer në këtë mënyrë si burim i krijimit të kësaj pasurie, në mungesë të disponimit prej subjektit të të ardhurave të veta. Të ardhurat e subjektit kanë shërbyer si burim për shlyerjen e*

huas në vitin 2013. Në këto kushte, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të pasaktë të burimit të të ardhurave që kanë shërbyer për pagesën e kështit të dytë për blerjen e këtij apartamenti në deklaratën e rivlerësimit të pasurisë, në kundërshtim me parashikimin e germës “a” të pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, por kjo pasaktësi në deklaram nuk mund të kualifikohet si një shkak për vendosjen e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra, sipas pikës 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, bazuar edhe në praktikën e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në vendimin nr. 31/2020 (JR), datë 18.11.2020.

37.2. Në përfundim të këtij arsyetimi, trupi gjykues vlerëson se situata faktike dhe ligjore e subjektit të rivlerësimit, e konstatuar për pasurinë automjet, nuk u gjet e mjaftueshme për t’u kualifikuar si deklaram i pamjaftueshëm, sipas pikës 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.

Llogari rrjedhëse e pagës në “Raiffeisen Bank” sh. a.

38. Në deklaratën *Vetting* 2017, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se disponon llogari rrjedhëse të pagës në “Raiffeisen Bank”, me gjendje 30.660 lekë. Pjesa takuese: 100%. Si burim krijimi rezultojnë të ardhurat nga paga. Subjekti, për vërtetimin e deklarimeve të tij, ka paraqitur dokumentacion ligjor provues⁴².

38.1. Në lidhje me përputhshmërinë e deklaramit - nga dokumentacioni i administruar nga “Raiffeisen Bank”⁴³ konfirmohet se subjekti i rivlerësimit disponon llogari page me gjendje 155.418 lekë.

38.2. Nga hetimi administrativ, kryesisht, bazuar në faktet e sipërpërmendura rezulton se deklarami i subjektit përputhet me dokumentacionin e administruar.

Depozitë në “Raiffeisen Bank” sh. a. (Fondi Prestigj)

39. Në deklaratën *Vetting* të vitit 2017, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se disponon depozitë në “Raiffeisen Bank” (Fondi Prestigj) dhe gjendja në datën 23.1.2017 është 5.092.000 lekë. Pjesa takuese: 100%. Burimi i krijimit: të ardhurat familjare ndër vite, vërtetuar edhe nga dëshmia testamentare e babait të saj. Pra, për vërtetimin e deklarimeve subjekti ka paraqitur dokumentacion ligjor provues⁴⁴.

39.1. Nga dokumentacioni i administruar nga banka⁴⁵ konfirmohet se subjekti i rivlerësimit është investitor në fondin “Raiffeisen Prestigj”, ku gjendja e llogarisë në datën 9.4.2018 është 5.310.565,29 lekë.

39.2. Në seksionin e të dhënave konfidenciale në deklaratën *Vetting*, subjekti ka deklaruar: *“Llogaria pranë ‘Raiffeisen Bank’ (Fondi Prestigj) është hapur më 3.3.2015, në shumën fillestare 4.484.560 lekë, me burim krijimi: nga pakësimi i llogarisë time bankare në ‘Raiffeisen Bank’, e krijuar nga të ardhurat familjare, nga interesat bankare, si dhe nga*

⁴²Vërtetim nr. ***, datë 25.1.2017, nga “Raiffeisen Bank”, ku vërtetohet gjendja e llogarisë së pagës për subjektin në vlerën 30.660 lekë, datë 25.1.2017, nxjerrje llogarie nga “Raiffeisen Bank”, gjendja në datën 25.1.2017, 30.660 lekë.

⁴³Shkresë nr. *** prot., datë 11.4.2018.

⁴⁴Vërtetim nr. ***, datë 25.1.2017, nga “Raiffeisen Bank”, ku vërtetohet gjendja e disponueshme më 25.1.2017, me vlerë 5.093.323 lekë, investuar në datën 3.3.2015, në vlerën 3.984.560 lekë dhe në datën 4.3.2015, në vlerën 500.000 lekë (nga të cilat 2.152.756 lekë kanë kaluar nga llogaria e babait I.Ç. me prokurë), vërtetim nr. ***, datë 25.1.2017, Raiffeisen Invest, vlera në datën 24.1.2017, 5.093.323 lekë.

⁴⁵Shkresë nr. *** prot., datë 12.4.2018.

*transferimi i shumës prej 2.152.756 lekësh nga llogaria e babait tim I.Ç., sipas prokurës së posaçme nr. ***, datë 27.2.2015, testamenti nr. ***, datë 20.4.2015 dhe dëshmisë testamentare nr. ***, datë 5.1.2016.”*

39.3. Subjekti, për vërtetimin e deklarimeve të tij, ka paraqitur dokumentacion ligjor provues⁴⁶. Nga hetimi i burimit të krijimit, Komisioni konstatoi se:

39.4. Subjekti ka dorëzuar në deklaratën *Vetting* prokurën e posaçme nr. ***, datë 27.2.2015, sipas së cilës, personi tjetër i lidhur/I.Ç., emëron subjektin si përfaqësues për tërheqjen e shumave të depozitave nga llogaria e tij në “Raiffeisen Bank” dhe kalimin e tyre në llogarinë e subjektit.

39.5. Më tej, në deklaratën *Vetting*, subjekti ka dorëzuar testamentin nr. *** rep., datë 20.4.2015, dhe dëshminë e trashëgimisë testamentare nr. ***, datë 5.1.2016, me kërkuese L.Ç. Sipas këtij dokumentacioni, ndër të tjera, nga ana e të ndjerit - personit tjetër të lidhur/I.Ç. është vendosur që depozitën në “Raiffeisen Bank” (për të cilën ka autorizuar me prokurë subjektin t’i kalojë në llogarinë e tij) t’ia dhurojë subjektit, duke qenë se është djali i parë dhe ka dhënë më shumë kontribut në investime për jetesën dhe shëndetin e familjes.

39.6. Nga dokumentacioni i administruar nga “Raiffeisen Invest” konstatohet se subjekti ka kryer investime si vijojnë:

- i. Në shumën 3.984.560 lekë, në datën 3.3.2015, shumë e transferuar nga llogaria nr. *** dhe ka si burim: (1) maturim depozite në shumën 1.831.795 lekë; dhe (2) transfertë llogaria e personit tjetër të lidhur/babait shumën 2.152.756 lekë.
- ii. Në shumën 500.000 lekë, në datën 4.3.2015, shumë e transferuar nga llogaria nr. ***, e cila është llogaria e pagës.

Shuma totale e blerjeve ka qenë 4.484.560 lekë. Diferenca me shumën e deklaruar nga subjekti vjen për shkak të çmimit të kuotave, çmim i cili është i ndryshueshëm në kohë.

39.7. Në lidhje më burimin e ligjshëm të shumës 2.152.756 lekë, të trashëguar nga babai, më poshtë paraqitet analiza financiare për të ardhurat, shpenzimet dhe pasuritë e personit tjetër të lidhur/babait.

+Të ardhura nga pensioni babai	2,143,443
+Të ardhura nga pensioni nëna	1,241,554
+Të ardhura nga interesat	462,943
-Shpenzime jetike 2 persona	2,644,910
-Dhënë hua	1,400,000
-Kaluar me trashëgimi	2,152,756
+Kthim huaja e dhënë	2,700,000
-Shtim/pakësim gjendje bankare	-876,296
Balanca vjetore	1,226,570

⁴⁶Nxjerrje llogarie në emër të z. I.Ç., datë printimi 23.1.2017, nxjerrje llogarie në emër të z. Artan Çupi, data printimi 32.1.2017 dhe 25.1.2017, vërtetim Raiffeisen Invest, ku vërteton se subjekti ka investuar në datën 3.3.2015, shumën 3.984.560 lekë dhe në datën 4.3.2015, shumën 500.000 lekë, prokurë e posaçme nr. ***, datën 27.2.2015, testament nr. ***, datë 20.4.2015, nga trashëgimlënësi I.Ç., dëshmi trashëgimie nr. ***, datë 5.1.2016, datë 5.1.2016.

39.8. Për sa më sipër, Komisioni konstaton se deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e administruar, si dhe rezulton se personit tjetër i lidhur/I.Ç. ka pasur të ardhura të ligjshme për krijimin e kësaj shume.

TË TJERA

40. Llogari në “Raiffeisen Bank” sh. a. (e hapur për llogari të motrës D.Ç.)

40.1. Në seksionin e të dhënave konfidenciale në deklaratën *Vetting* të vitit 2017, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se disponon llogari në “Raiffeisen Bank” në emrin e tij, me gjendje shumë 85.430 lekë. Kjo shumë nuk i përket subjektit, por motrës së tij që jeton në Itali, D.Ç., shumë e cila i është kthyer nga ISSH-ja me shkresën datë 3.8.2015, sipas vërtetimit bankar datë 20.7.2016. Motra e subjektit e ka autorizuar nëpërmjet prokurës së posaçme nr. ***, datë 10.6.2016, për kryerjen e veprimeve, pasi ajo nuk ka llogari bankare dhe nuk ishte e mundur të paraqitej për të kryer këto veprime. Për vërtetimin e deklarimeve, subjekti ka paraqitur dokumentacion ligjor provues⁴⁷.

40.2. Nga hetimi i burimit të krijimit, Komisioni konstatoi se subjekti ka dorëzuar në deklaratën *Vetting* prokurën e posaçme nr. ***, datë 10.6.2016, sipas së cilës personi tjetër i lidhur/D.Ç. emëron subjektin si përfaqësues për të vepruar në emër të saj për tërheqjen në çdo bankë të nivelit të dytë, të shumës për kthim kontributesh nga Agjencia e Sigurimeve Shoqërore Mat.

40.3. Më tej, subjekti ka paraqitur vërtetimin nr. *** prot., datë 3.8.2015 dhe nr. *** prot., datë 21.3.2016, nga ISSH-ja Dibër, për kthimin e kontributeve të paguara jashtë kriterëve ligjore të znj. D.Ç., në vlerën 85.138 lekë.

40.4. Sa më sipër, Komisioni vërtetoi se deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e administruar nga hetimi.

Në lidhje me gjendjen e likuiditeteve *cash* në fund të çdo viti

41. Në deklaratimet periodike ndër vite, subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaratimet si vijojnë:

Viti	Deklarimi në deklaratat periodike vjetore
2003	Nuk deklarohen shtesa/pakësime/gjendje
2004	Nuk deklarohen shtesa/pakësime/gjendje për vitin 2004, por deklaruar <i>cash</i> i kursyer nga fillimi 1.000.000 lekë
2005	Nuk deklarohen shtesa/pakësime/gjendje
2006	Nuk deklarohen shtesa/pakësime/gjendje
2007	Nuk deklarohen shtesa/pakësime/gjendje
2008	Nuk deklarohen shtesa/pakësime/gjendje
2009	Gjendje në lekë, <i>cash</i> , të krijuara nga diferenca e të ardhurave, të përfituara gjatë vitit 2009: 600.000 lekë
2010	Gjendje në lekë, <i>cash</i> , të krijuara nga diferenca e të ardhurave, të përfituara gjatë vitit 2010: 500.000 lekë

⁴⁷Nxjerrje llogarie në emër të shtetasit Artan Çupi, datë 22.7.2016, ku vërtetohet kalimi i vlerës 85.434 lekë nga dega e ISSH-së Mat, për znj. D.Ç., përfaqësuar me prokurën e posaçme nr. ***, datë 10.6.2016, shkresa nr. ***, datë 3.8.2015, shkresa nr. ***, datë 21.3.2016.

2011	Gjendje në lekë, <i>cash</i> , të krijuara nga diferenca e të ardhurave, të përfituara gjatë vitit 2011: 400.000 lekë
2012	Gjendje në lekë, <i>cash</i> , të krijuara nga diferenca e të ardhurave, të përfituara gjatë vitit 2012: 500.000 lekë
2013	Gjendje në lekë, <i>cash</i> , të krijuara nga diferenca e të ardhurave, të përfituara gjatë vitit 2013: 500.000 lekë
2014	Gjendje në lekë, <i>cash</i> , të krijuara nga diferenca e të ardhurave, të përfituara gjatë vitit 2014: 500.000 lekë
2015	Nuk deklarohen shtesa/pakësime/gjendje
2016	Nuk deklarohen shtesa/pakësime/gjendje

41.1. Me anë të pyetësorit nr. 1, subjektit iu kërkua të deklarojë saktë se sa ka qenë gjendja e likuiditeteve *cash*, në fund të çdo viti, me qëllim që të saktësohej nëse ato ishin gjendje apo shtesa. Në përgjigje të pyetësorit⁴⁸, subjekti sërish nuk e specifikon qartë nëse janë shtesa apo gjendje, por pretendon që është diferenca me gjendjen që ka pasur në llogarinë rrjedhëse. Sipas tij, shumat e deklaruara si gjendje në fund të çdo viti, i ka derdhur në depozitën bankare. Gjendja e likuiditeteve *cash* të çdo fundviti e depozituar në kohën e maturimit në muajin janar të vitit pasardhës përbëhet nga shuma *cash* në llogarinë bankare “balanca në fund” që ishte në llogarinë e tij personale, të cilës i shtoheshin edhe lekët *cash* që ka pasur gjatë vitit, duke formuar shumën e deklaruar në çdo deklaratë vjetore, të cilën e ka kaluar në depozitë bankare.

41.2. Komisioni vëren se pretendimet e subjektit nuk qëndrojnë për këto arsye: (i) subjekti deklaron në deklaratat periodike që bëhet fjalë për lekë *cash* (deklarimi i tij në vitin 2004 tregon që është i qartë për këtë koncept); (ii) në periudhën 2005 – 2008, nuk ka deklarime vlerash nga subjekti, ndërkohë që llogaria rrjedhëse është me gjendje; (iii) në vitet 2012 dhe 2014 gjendja e llogarisë rrjedhëse bankare është më e lartë se gjendja e deklaruar nga subjekti.

41.3. Për këtë arsye, meqenëse subjekti specifikon që vlerat e deklaruara çdo vit janë “*cash* të krijuara nga diferenca e të ardhurave të përfituara gjatë vitit”, shumat e deklaruara prej tij janë konsideruar si shtesa për efekt të analizës financiare.

41.4. Nga faktet e analizuara, Komisioni, në përfundim të hetimit administrativ, i kërkoi subjektit të paraqesë shpjegime lidhur me konstatimin se nga analiza financiare sipas deklarimeve ndër vite, gjendja e likuiditeteve *cash* në fund të vitit 2016 është në shumën 4.000.000 lekë, ndërkohë që në deklaratën *Vetting* subjekti nuk ka deklaruar gjendje likuiditetesh jashtë sistemit bankar.

41.5. Subjekti i rivlerësimit, në prapësimet e tij, pas dërgimit të rezultateve të hetimit, shpjegoi se: “[..] në të gjitha rastet që kam deklaruar si depozita në lekë janë shuma të krijuara nga shuma e lekëve gjendje në llogarinë rrjedhëse në fund të vitit dhe shtuar gjendja e lekëve *cash* dhe këto dy shuma i kam kaluar (derdhur) në shumën e depozitës në bankë që përbëjnë lekët e kursyera nga të ardhurat e mia familjare”.

Ndërsa në seancën dëgjimore subjekti shpjegoi se: “[..] Të gjitha rastet që kam deklaruar depozitat në lekë, që unë i kam derdhur në llogarinë time në fund të çdo viti, janë shuma të cilat janë krijuar nga shuma e lekëve që gjenden në llogarinë rrjedhëse në fund të çdo viti, si dhe shtuar gjendja e lekëve *cash* që kanë qenë në momentin që unë kam krijuar depozitën dhe

⁴⁸E-mail datë 25.11.2019.

i kam derdhur në 'Raiffeisen Bank'. Këto shpjegime janë dhënë, janë konstatuar më parë dhe nga ILDKPKI-ja, kur kam dhënë shpjegimet në dy data, në tetor dhe nëntor të vitit 2009 dhe janë dhënë shpjegime dhe lidhur me këtë konstatim, për këtë përgjigje që jap tashti. Këto i kam dhënë edhe në pyetësorin nr. 1 tek shtesë që më është kërkuar nga Komisioni në pyetjen 12, ku kam deklaruar si është krijuar gjendja cash, diferenca e të ardhurave për çdo vit që unë kam bërë deklarin vjetor. Dua t'i deklaroj këto se në fakt ka, pranoj faktin se ka pasaktësira në deklarinmet vjetore të çdo viti që unë kam dhënë në ILDKPKI, pasi në këto deklarime, për shkak dhe të mosdijes, nuk kemi arritur të plotësojmë deklaratën ashtu siç duhet lidhur me pasqyrimin ose deklarinmet e tepricave midis të ardhurave dhe shpenzimeve për çdo vit kalendarik. Vetëm pas takimit që unë kam pasur në vitin 2009 në ILDKPKI jam informuar dhe aty më është bërë e qartë që tashmë deklarinmet i pasurisë duhet të përmbajë edhe tepricat, po ashtu dhe interesat e fituara nga depozita ime që kam mbajtur në bankë. Unë në asnjë vit nuk i kam deklaruar këto, dhe nga ana e ILDKPKI-së, më është thënë që duhet të bësh edhe deklarinmet e diferencës, apo interesat që fitohen gjatë një viti qëndrimi të depozitës në bankë. Këto pasaktësira unë i pranoj, po thjesht dua të deklaroj që të gjitha këto nuk i vijnë për faktin se unë kam synuar të fsheh, të bëj deklarata të rreme, po thjesht ka pasaktësira që janë evidentuar ndoshta në vite edhe shumë raste të tjera, kjo ka qenë arsyeja e mospërputhjes së këtyre deklarinmeve, dy deklarinmeve”.

Arsyetimi ligjor në lidhje me provat dhe ligjin e zbatueshëm

42. Komisioni, duke pasur parasysh: (i) deklarinmet e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë për procesin kalimtar *Vetting*; (ii) raportin e hollësishëm të ILDKPKI-së, deklarata periodike dhe provat shpresore të administruara nga ky institucion; (iii) provat shpresore të administruara nga Komisioni sipas neneve 49 dhe 50, të ligjit nr. 84/2016; (iv) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ dhe gjatë seancës dëgjimore, arsyeton se subjekti nuk ka qenë i saktë në deklarinmet e tij në deklarata periodike për sa i përket kursimeve *cash*.

42.1. Nga hetimi ka rezultuar se subjekti nuk ka gjendje *cash* në shtëpi në shumën 4.000.000 lekë, si dhe nuk ka rezultuar se përpara plotësimit të deklaratës *Vetting* të ketë depozituar në institucionet bankare gjendje *cash* mbi vlerën 1.500.000 lekë me qëllim plotësimin e kërkesave të parashikuara nga shtojca 2 e ligjit nr. 84/2016.

Viti	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016
Gjendje cash në fund të çdo viti	1,000,000	1,000,000		-	-	-	600,000	500,000	400,000	500,000	500,000	500,000	-	-

42.2. Në analizën financiare, Komisioni do t'i konsiderojë këto shuma si gjendje në fund të çdo viti. Komisioni, në kushtet kur vërehet se kjo pasaktësi në deklarinmet e subjektit të rivlerësimit gjendet në deklarinmet periodik të interesave, në mbështetje të qëndrimit të mbajtur prej Kolegjit në çështje të ngjashme, e cila përbën tashmë jurisprudencë të konsoliduar të tij⁴⁹, vlerëson se një deklarinmet i pasaktë në deklarinmet e mëparshme periodike të interesave nuk mund të konsiderohet se është bërë në kundërshtim me përcaktimin e germës “a” të pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, për rrjedhojë nuk është element i mjaftueshëm për t'u konsideruar si

⁴⁹Vendimet e Kolegjit: nr. 9/2020 (JR), datë 26.6.2020; nr. 16/2020 (JR), datë 13.7.2020; nr. 31/2020 (JR), datë 18.11.2020.

një shkak i vetëm dhe i veçuar, që prodhon situatën e deklaramit të pamjaftueshëm, në kuptim të pikës 3 të nenit 61 të ligjit të sipërcituar.

PASURITË E PERSONIT TË LIDHUR/BASHKËSHORTJA E SUBJEKTIT

Llogari rrjedhëse në “Raiffeisen Bank”

43. Në deklaratën *Vetting* të vitit 2017, bashkëshortja e subjektit ka deklaruar se disponon llogari rrjedhëse me gjendje 111 lekë në “Raiffeisen Bank”. Pjesa takuese: 100%. Nuk është deklaruar burimi i krijimit. Subjekti, për vërtetimin e deklarimeve të tij, ka paraqitur dokumentacion ligjor provues⁵⁰. Nga dokumentacioni i administruar nga “Raiffeisen Bank”⁵¹ konfirmohet se bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit ka llogari në lekë në gjendje 0 (zero) lekë.

43.1. Komisioni konstaton se deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e administruar nga hetimi.

Toka bujqësore në fshatin B., Bashkia Klos

44. Në deklaratën *Vetting* të vitit 2017, bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit ka deklaruar se disponon tokë bujqësore me sip. 1800 m²; tokë bujqësore me sip. 1100 m²; tokë bujqësore me sip. 750 m²; tokë bujqësore me sip. 950 m²; tokë bujqësore me sip. 3400 m², të ndodhura në fshatin B., Bashkia Klos. Burimi i krijimi: nga ligji nr. 7501 dhe vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat, për lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë së babait nr. ***, datë 8.7.2013, subjekti, për vërtetimin e deklarimeve të tij, ka paraqitur dokumentacion ligjor provues⁵².

44.1. Nga dokumentacioni i administruar nga ASHK-ja Mat⁵³ konfirmohet se bashkëshortja e subjektit ka në bashkëpronësi (të përfitur nga trashëgimia) 1/5 pjesë të pasurive me nr. *** - 3400 m², nr. *** – 750 m², nr. *** – 950 m², nr. *** – 1800 m², nr. *** – 1100 m², zëri kadastral “arë” që ndodhet në z.k. ***, fshati B., Bashkia Klos, vërtetuar kjo me kartelat e pasurisë.

44.2. Me vendimin nr. ***, datë 8.7.2013, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat, vërtetohet lëshimi i dëshmisë së trashëgimisë ligjore të babait të bashkëshortes së subjektit, duke përcaktuar si trashëgimtarë të radhës së parë pesë fëmijët (ndërmjet tyre edhe bashkëshortja e subjektit), të cilët trashëgojnë në mënyrë të barabartë midis tyre 1/5 pjesë secili.

44.3. Referuar shkresës nr. *** prot., datë 14.7.2014, Bashkia Klos, me AMTP-në nr. ***, datë 21.11.1996, vërteton se bazuar në ligjin nr. 7501, datë 19.7.1991, “Për tokën”, shtetasi E.S. (babai i personit të lidhur/V.Ç.) zotëron tokë bujqësore me sip. 10110 m², në fshatin b., Bashkia

⁵⁰Nxjerrje llogarie në emër të shtetases V.Ç., datë 24.1.2017, vlera 111 lekë, në datën 16.1.2017.

⁵¹Shkresa *** prot., datë 11.4.2018.

⁵²Shkresë nga ZVRPP-ja Mat: nr. ***, datë 23.1.2017; certifikatë pronësie nr. ***, datë 4.5.2016, për pasurinë “arë” me sip. 1800 m² + kartelë pasurie, në pronësi të shtetases V.Ç. 1/5; certifikatë pronësie nr. ***, datë 4.5.2016, për pasurinë “arë”, me sip. 1100 m² + kartelë pasurie, në pronësi të shtetases V.Ç. 1/5; certifikatë pronësie nr. ***, datë 4.5.2016 për pasurinë “arë”, me sip. 950 m² + kartelë pasurie, në pronësi të shtetases V.Ç. 1/5; certifikatë pronësie nr. ***, datë 4.5.2016, për pasurinë “arë”, me sip. 3400 m² + kartelë pasurie, në pronësi të shtetases V.Ç. 1/5; certifikatë pronësie nr. ***, datë 4.5.2016, për pasurinë “arë”, me sip. 750 m² + kartelë pasurie, në pronësi të shtetases V.Ç. 1/5.

⁵³Shkresa nr. *** prot., datë 23.4.2018, praktika bashkëlidhur.

Klos/Mat.

44.4. Nisur nga faktet e analizuara, Komisioni i kërkoi subjektit të paraqesë shpjegime lidhur me faktin se referuar AMTP-së, babai i personit të lidhur/V.Ç. zotëron tokë bujqësore me sip. 10110 m², ndërkohë nga deklaratimet dhe kartelat e pasurisë rezulton se bashkëshortja e subjektit posedon 1/5 pjesë të tokave bujqësore në sip. totale 8.000 m².

44.5. Subjekti i rivlerësimit, në prapësimet e tij në përgjigje të barrës së provës, shpjegoi se: *“[...] shkaku i diferencës së sipërfaqes së përgjithshme të tokës bujqësore është pasi sipërfaqja e të gjitha parcelave të pasqyruara në AMTP nuk tregon sipërfaqen reale, janë pasqyruar më tepër. Gjatë regjistrimit të këtyre parcelave në kartelat e pasurisë janë bërë matjet reale dhe shuma e të gjitha parcelave është 8000 m². Pra, shuma e pasqyruar në kartelat e pasurisë me sip. prej 8.000 m² është sipërfaqja reale e nxjerrë nga matjet faktike në terren”.*

Arsyetimi ligjor në lidhje me provat dhe ligjin e zbatueshëm

45. Komisioni, duke pasur parasysh: (i) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë për procesin kalimtar *Vetting*; (ii) raportin e hollësishëm të ILDKPKI-së, deklaratat periodike dhe provat shkresore të administruara nga ky institucion; (iii) provat shkresore të administruara nga Komisioni sipas neneve 49 dhe 50, të ligjit nr. 84/2016; (iv) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ dhe gjatë seancës dëgjimore, arsyeton se subjekti arriti të shpjegojë bindshëm mospërputhjet e konstatuara gjatë hetimit.

TË TJERA

Në lidhje me huan në shumën 500.000 lekë, dhënë shtetases A.M.

46. Në DPV-në e vitit 2011, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar dhënie hua shtetases A.M. në shumën 500.000 lekë, sipas kontratës së huas nr. ***, datë 11.4.2011, në intervalin kohor 11.4.2011 – 15.1.2012, me interes 10%/muaj. Në DPV-në e viti 2012, subjekti deklaroi likuidimin e huas bashkë me interesin në vlerën 550.000 lekë, në afatin e përcaktuar në kontratë më 15.1.2012. Duke qenë se subjekti nuk ka dorëzuar pagesën për detyrimet tatimore, këto të ardhura nuk janë konsideruar në analizën financiare.

PASURITË E PERSONIT TË LIDHUR/DJALI I SUBJEKTIT

Llogari rrjedhëse në “Raiffeisen Bank”

47. Në deklaratën *Vetting* të vitit 2017, personi i lidhur ka deklaruar se disponon llogari rrjedhëse me gjendje në shumën 35.300 lekë, në “Raiffeisen Bank”. Pjesa takuese: 100%. Nuk është deklaruar burimi i krijimit, por subjekti ka dorëzuar vërtetimin datë 20.1.2017, të Bashkisë Mat, me anë të të cilit vërtetohet se djali i tij është i punësuar në pozicionin e specialistit në Sektorin Juridik pranë kësaj bashkie. Subjekti, për vërtetimin e deklarimeve të tij, ka paraqitur dokumentacion ligjor provues⁵⁴.

47.1. Nga dokumentacioni i administruar nga banka⁵⁵ konfirmohet se subjekti i rivlerësimit disponon llogari page me gjendje 422 lekë në “Raiffeisen Bank”. Komisioni konstaton se

⁵⁴Nxjerrje llogarie datë 24.1.2017, në “Raiffeisen Bank”, në emër të shtetasit E.Ç., gjendje në datën 24.1.2017, shuma 35.300 lekë.

⁵⁵Shkresë nr. *** prot., datë 11.4.2018.

deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e administruar nga hetimi.

Analiza financiare sipas viteve 2003 – 2016

48. Komisioni kreu analizën financiare duke marrë në konsideratë pasuritë, të ardhurat, detyrimet dhe shpenzimet e subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur, sipas deklarimeve ndër vite në DPV dhe dokumentacionit të administruar nga hetimi, për sa vijon në tabelë:

Viti	Pasuri	Ndryshim likuiditete cash	Ndryshim likuiditete bankë	Të ardhurat	Detyrimet	Shpenzime	Diferenca për shpenzime
2003	0	0	0	871,691	0	529,320	342,371
2004	0	0	0	1,214,892	-435,162	529,320	250,410
2005	0	0	1,237,921	1,196,214	0	754,881	-796,588
2006	0	0	-608,451	1,366,697	0	607,785	1,367,362
2007	2,000,000	0	718,283	1,289,097	700,000	2,135,360	-2,864,545
2008	-876,353	0	1,812,833	2,135,590	0	793,954	405,156
2009	0	600,000	217,952	1,814,964	0	941,147	55,864
2010	0	500,000	-1,681,234	1,939,524	-2,000,000	802,945	317,813
2011	0	400,000	44,405	1,727,673	-500,000	1,040,624	-257,356
2012	1,400,000	500,000	1,303,785	1,854,202	1,900,000	1,107,283	-556,866
2013	0	500,000	-1,449,066	2,058,685	-1,400,000	1,291,864	315,888
2014	0	500,000	746,211	2,258,405	0	1,375,682	-363,488
2015	0	0	2,100,205	4,312,843	0	1,701,048	511,590
2016	0	0	158,419	2,288,558	85,430	1,512,961	702,609
TOTAL	2,523,647	3,000,000	4,601,262	26,329,034	-1,649,732	15,124,175	-569,781

48.1. Nga faktet e analizuara, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i interpretuar në lidhje me nenin D të Aneksit të Kushtetutës, Komisioni i kaloi barrën e provës subjektit në lidhje me:

- i. për vitin 2005 ka mungesë burimesh të ligjshme në shumën 796.588 lekë;
- ii. për vitin 2007 ka mungesë burimesh të ligjshme si vijon: për blerjen e apartamentit, mungesë 1.300.000 lekë; për kryerjen e shpenzimeve dhe shtimin e llogarive bankare, mungesë 1.564.545 lekë;
- iii. për vitin 2011 ka mungesë burimesh të ligjshme në shumën 257.356 lekë;
- iv. për vitet 2012 ka mungesë burimesh të ligjshme në shumën 556.866 lekë;
- v. për vitin 2014 ka mungesë burimesh të ligjshme në shumën 363.488 lekë.

48.2. Subjekti i rivlerësimit, në prapësimet e tij në përgjigje të barrës së provës, shpjegoi se: “[...] në lidhje me analizën e mësipërme kam dhënë sqarime përpara ILDKPKI-së, në datën 23.10.2009 dhe i qëndroj atyre në lidhje me argumentimin e kësaj analize. Veprimet për shitjen e apartamentit me sip. 57.82 m², në shumën 1.500.000 lekë janë kryer në vitin 2009 me kontratën e shitblerjes nr. ***, datë 21.10.2009, por vlera e lekëve që i përket çmimit të shitjes së këtij apartamenti është marrë nga blerësi P.N., në qershor të vitit 2008 dhe kjo shumë është derdhur prej meje në depozitën që kisha në ‘Raiffeisen Bank’.

Për sa i përket mospërputhjeve midis vlerës së deklaruar prej meje në deklaratat e pasurisë dhe përgjigjes së ardhur nga ‘Raiffeisen Bank’ saktësoj se depozita në lekë në shumën 50.000 lekë, e deklaruar në vitin 2005 është shtesë për këtë vit, por pranë kësaj banke është derdhur edhe gjendje cash që kam pasur unë në banesë dhe që është deklaruar në deklaratën e vitit

2004. Gjendja cash në shumën 1.000.000 lekë është derdhur në bankë në datën 12.06.2005 dhe është gjendje në depozitën që ndodhet pranë kësaj banke. Shtesa prej 500.000 lekë, e deklaruar prej meje në deklaratën e vitit 2005 i takon shumës që ndodhej në llogarinë e pagës time dhe të bashkëshortes në momentin e dorëzimit të deklaratës mars të vitit 2006. Në vitin 2006, gjendja e depozitës është e vërtetë që është në shumën 328.050 lekë, pasi unë kam bërë një tërheqje të shumës që ndodhej në depozitë pranë kësaj banke për të ndihmuar vëllanë tim (B.Ç.) që bleu apartament, shumë të cilën vëllai im ma ka kthyer në vitin 2007 dhe pas këtij momenti unë kam kryer derdhjet në depozitën time, e cila rezulton në fund të vitit 2007 në shumën 1.246.724 lekë. Në vitin 2008 gjendja e depozitës në bankë është në shumën 2.893.209 lekë, për arsye se gjendjes së mbartur nga viti 2007 i është shtuar vlera e shitjes së apartamentit në shumën 1.450.000 lekë, po kështu janë kryer edhe veprime të kalimit në këtë depozitë nga llogaria rrjedhëse e pagave në llogarinë ku është kjo depozitë në të njëjtën bankë. Vazhdoj që huan e marrë babait dhe vëllait në shumën 2.000.000 lekë për blerjen e apartamentit ta kem detyrim të pashlyer”.

48.3. Në lidhje me mobilimin e apartamentit, subjekti u pyet gjatë seancës dëgjimore, ku deklaroi se në pyetësorin standard ka pasur për qëllim të deklarojë vlerën e mobilimit nga viti 2007 deri në deklaratën *Vetting*, pasi shtëpia e blerë ka qenë e mobiluar dhe ai ka bërë mobilim shtesë gjatë viteve.

48.4. Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit pas kalimit të barrës së provës dhe ato të dhëna në seancë gjyqësore, vlerëson që shpenzimet e mobilimit të ndahen në mënyrë të barabartë për periudhën 2007 – 2016 për sa kohë subjekti ka deklaruar se ka kryer shpenzime mobilimi nga viti 2007 - deri në deklaratën *Vetting*. Në lidhje me shumën 1.000.000 lekë, për të cilën nga analiza financiare rezulton se subjekti ka pasur të ardhura të mjaftueshme për krijimin e saj, do të konsiderohet si burim për krijimin e depozitës në shumën 1.000.000 lekë në datën 6.12.2005, në “Raiffeisen Bank”. Në lidhje me shumën 1.300.000 lekë Komisioni ka analizuar në pikën 29.9.9, duke e konsideruar si të krijuar me të ardhura të mjaftueshme.

48.5. Në përfundim, Komisioni ka kryer edhe një herë analizën financiare për periudhën 2003 – 2016, nga ku ka rezultuar se subjekti rezulton me pamundësi financiare në shumën 480.045 lekë në vitin 2007, në shumën 64.636 lekë në vitin 2009 dhe në shumën 277.366 lekë, në vitin 2012.

Viti	Pasuri	Ndryshim likuiditete cash	Ndryshim likuiditete bankë	Të ardhurat	Detyrimet	Shpenzime	Diferenca për shpenzime
2003	0	0	0	871,691	0	529,320	342,371
2004	0	0	0	1,214,892	-435,162	529,320	250,410
2005	0	-1,000,000	1,237,921	1,196,214	0	754,881	203,412
2006	0	0	-608,451	1,366,697	0	607,785	1,367,362
2007	2,000,000	0	718,283	1,289,097	2,000,000	1,050,860	-480,045
2008	-876,353	0	1,812,833	2,135,590	0	914,454	284,656
2009	0	600,000	217,952	1,814,964	0	1,061,647	-64,636
2010	0	-100,000	-1,681,234	1,939,524	-2,000,000	923,445	797,313
2011	0	-100,000	44,405	1,727,673	-500,000	1,161,124	122,144
2012	1,400,000	100,000	1,303,785	1,854,202	1,900,000	1,227,783	-277,366
2013	0	0	-1,449,066	2,058,685	-1,400,000	1,412,364	695,388
2014	0	0	746,211	2,258,405	0	1,496,182	16,012

2015	0	-500,000	2,100,205	4,312,843	0	1,821,548	891,090
2016	0	0	158,419	2,288,558	85,430	1,633,461	582,109
TOTAL	2,523,647	-1,000,000	4,601,262	26,329,034	- 349,732	15,124,175	4,730,219

48.6. Në përfundim, subjekti rezulton se ka pasur mungesë të të ardhurave të ligjshme për periudhën 2003 – 2016 në shumën 822.047 lekë, në përputhje me parashikimin e germës “b”, të pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, por kjo situatë, në vlerësimin e trupit gjykues, është e tillë që nuk mund të ngrihet në nivelin e një shkaku shkarkimi në drejtim të vlerësimit të kriterit të pasurisë, bazuar edhe në praktikën e Kolegjit të Posaçëm të Apelit⁵⁶.

48.7. Duke gjykuar mbi bazën e parimit të proporcionalitetit, deklaratimet e pasakta të konstatuara apo mungesa financiare si më sipër nuk duhet të ndikojnë në vlerësimin tërësor të pasurisë së subjektit. Komisioni çmon se për shkak të peshës specifike të vogël të tyre dhe mungesës së pasojave, ato nuk cenojnë figurën e gjyqtarit dhe as besimin e publikut të drejtësisë.

48.8. Për sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit Artan Çupi ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, sipas parashikimit të germës “a”, të nenit 59/1, të ligjit nr. 84/2016.

B. KONTROLI I FIGURËS

49. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklaratimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2006, si dhe ka dërguar një raport të arsyetuar nr. ***, datë 15.10.2018, deklasifikuar plotësisht me vendimin nr. ***, datë 17.10.2018, të KDZH-së, duke konkluduar mbi “papërshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit Artan Çupi”.

49.1. Më tej, në po të një njëjtin raport specifikohet se pas informacionit shtesë të ardhur nga autoritetet verifikuese, rezulton se për subjektin e rivlerësimit disponohen të dhëna për periudha kohore, ku ngrihen dyshime të arsyeshme për përfshirje në veprimtari të kundërligjshme, të shfaqur në formën e korrupsionit pasiv të gjyqtarit, në proceset gjyqësore në ndjekje në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Mat, e konkretisht: “*Subjekti i rivlerësimit Artan Çupi, në bashkëpunim me ..., në cilësinë e avokatit, kundrejt marrëdhënieve korruptive ka ndikuar, favorizuar disa persona në procese penale të zhvilluara në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Mat.*”

Për disa raste të mundshme të implikimit në veprimtari të kundërligjshme të subjektit të rivlerësimit Artan Çupi, në periudha të ndryshme kohore, sipas të dhënave dyshohet se subjekti i rivlerësimit Artan Çupi, në bashkëpunim me ..., në cilësinë e avokatit të të pandehurit ... janë përpjekur nëpërmjet shfrytëzimit të hapësirave ligjore të mundësojnë lirimin e këtij të fundit”.

49.2. Po sipas të dhënave që disponohen, rezulton se subjekti i rivlerësimit Artan Çupi ka bashkëpunuar edhe me anëtarë të tjerë të kësaj gjykate dhe avokatët e të pandehurit për

⁵⁶Vendimi nr. 31/2020 (JR), datë 18.11.2020, i Kolegjit.

favorizimin dhe lirimin e tij nëpërmjet marrëdhënies korruptive të vendosur mes tyre dhe kundrejt shpërblimit, marrjes së mitës.

Sa më sipër, grupi i punës shprehet në raport se:

a. *“Vlerësojmë se gjendemi në një situatë që evidenton forma të shfaqjes së korrupsionit pasiv të gjyqtarëve dhe ushtrimit të ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrjnë funksione publike gjatë ushtrimit të detyrës, ndër radhët e funksionarëve të sistemit të drejtësisë, e jo vetëm, konkretisht, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Mat. Mbi bazën e të dhënave që disponohen nga autoriteti verifikues, rezulton se marrëdhënia për shkak të detyrës ndërmjet personave, si avokatit të të pandehurit dhe subjektit të rivlerësimit, në cilësinë e anëtarit të trupit gjykues, është tejkualuar, duke i kapërcyer limitet e kësaj lidhjeje dhe vendosjen e një kontakti të papërshtatshëm, i cili përmbush kriteret e parashikuara për të qenë një i tillë sipas pikës 6, të nenit 3, pra: ‘Kontakt i papërshtatshëm - është një takim, komunikim elektronik ose çfarëdoq mënyre tjetër takimi i qëllimshëm, që nuk është në pajtim me ushtrimin e detyrës nga subjekti i rivlerësimit..’ dhe germës ‘c’ pra ‘subjekti i rivlerësimit ose një person i lidhur me të ka shkëmbyer para, favore, dhurata ose pasuri me një person të përfshirë në krimin e organizuar’ të nenit 38, të ligjit nr. 84/2016. Madje marrëdhënia korruptive dhe ushtrimi i ndikimit të paligjshëm për një favor kundrejt shpërblimit monetar ndërmjet personave të sipërcituar shtrihet edhe ndaj personave të tjerë, si funksionarë të drejtësisë e pjesë e vendimmarrjes në gjykim, duke cenuar në tërësi procesin e gjyqimit, në papajtueshmëri me detyrën funksionale të gjithsecilit prej tyre.*

b. *Gjykojmë se e gjithë kjo veprimtari e paligjshme e evidentuar nga autoriteti verifikues, i përmbahet përcaktimit të pikës 8, të nenit 3, të ligjit nr. 84/2016, që parashikon veprat penale të nenit 75/a të Kodit të Procedurës Penale, ku përfshihen: ‘krimi i organizuar, trafikimi dhe korrupsioni’.*

c. *Gjithashtu, kjo marrëdhënie korruptive ndërmjet avokatit të të pandehurit dhe subjektit të rivlerësimit, në cilësinë e gjyqtarit të çështjes në gjykim apo ndërmjet gjyqtarëve të një trupi gjykues, veçmas asaj të qenit kolegë dhe për shkak të detyrës, evidentohen rrethanat e konstatimit të faktit se ekzistojnë kontakte të papërshtatshme sipas përcaktimit të pikës 6, të nenit 3, të ligjit nr. 84/2016.*

d. *Në përfundim, DSIK-ja gjykon se veprimtaria korruptive e subjektit të rivlerësimit, në bashkëpunim, cenon drejtpërsëdrejti pastërtinë e figurës, çfarë përmbush plotësisht kriterin e përcaktuar në germën “c”, të nenit 37, të ligjit nr. 84/2016, ku z. Artan I. Çupi, vlerësohet si individ i mundshëm për t’u vënë nën presion nga strukturat kriminale”.*

49.3. Grupi i punës nga të dhënat e siguruara nga autoritetet verifikuese dhe bazuar në vlerësimin se koncepti thelbësor përcaktues i integritetit profesional të subjektit të rivlerësimit, është sistemi i vlerave që tregon për pastërtinë e figurës së gjithsecilit prej tyre, ndryshon konstatimin fillestar të dhënë për subjektin e rivlerësimit, nga përshtatshmëri në vijimin e ushtrimit të detyrës në papërshtatshmërinë në vazhdimin e detyrës për subjektin e rivlerësimit Artan Çupi.

Hetimi i kryer nga Komisioni mbi kontrollin e figurës

50. Në vijim të informacioneve të mësipërme, në bazë të nenit Ç të Aneksit të Kushtetutës dhe në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, në bashkëpunim me ONM-në ka kryer disa aksese në dokumentacionin e klasifikuar të poseduar nga institucionet verifikuese, për t'i studiuar ato si dhe për të verifikuar bazueshmërinë e konkluzioneve në të cilat kishin arritur raportet e sipërpërmendura.

50.1. Në sajë të informacioneve të marra nga raportet e DSIK-së, më tej, Komisioni, për të verifikuar informacionin, i është drejtuar Prokurorisë së Përgjithshme⁵⁷ dhe Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda⁵⁸, nëse në ngarkim të subjektit ka të regjistruar procedim penal, mosfillim ose pushim.

50.2. Më tej, me anë të postës elektronike, Komisioni pyeti subjekti e rivlerësimit: (1) nëse ka pasur kontakte të papërshtatshme në formën e një takimi, komunikimi elektronik ose çfarëdolloj mënyre takimi të qëllimshëm me një ose më shumë persona të përfshire në krimin e organizuar gjatë viteve 2017, 2018 dhe 2019 dhe subjekti ka deklaruar se nuk ka pasur në asnjë rast apo rrethanë kontakte të papërshtatshme në formën e një takimi, komunikimi elektronik, ose çfarëdolloj mënyre takimi të qëllimshëm, me një ose më shumë persona të përfshirë në krimin e organizuar gjatë viteve 2017, 2018 dhe 2019; (2) nëse ka pasur kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar gjatë viteve 2017, 2018 dhe 2019 dhe subjekti ka deklaruar se nuk ka pasur kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar gjatë viteve 2017, 2018 dhe 2019; (3) nëse ka ndonjë gjë tjetër për të deklaruar në lidhje me kontrollin e figurës, që mbase Komisioni ka harruar ta pyesë dhe/ose subjekti ka harruar ta deklarojë dhe subjekti ka deklaruar se në lidhje me kontrollin e figurës së tij nuk ka asgjë tjetër për të deklaruar.

50.3. Nga hetimi i Komisionit është administruar dokumentacioni si: (i) praktika e përcjellë nga Prokuroria e Përgjithshme me shkresën nr. *** port., datë 26.12.2019; dhe (ii) shkresa nr. *** prot., datë 14.10.2019, e Prokurorisë së Krimeve të Rënda.

Nga faktet e analizuara Komisioni i kërkoi subjektit të paraqesë shpjegime lidhur me dyshime të arsyeshme për përfshirjen në veprimtari të kundërligjshme, të cilat cenojnë figurën e subjektit të rivlerësimit.

50.4. Subjekti i rivlerësimit, në prapësimet e tij në përgjigje të barrës së provës, shpjegoi: “[...] *Kundërshtoj konkluzionin në lidhje me papërshtatshmërisë time në vazhdimin e detyrës. Nuk ka asnjë fakt, rrethanë, veprimtari të paligjshme apo provë konkrete që tregon apo provon përfshirjen time në veprimtari të kundërligjshme, e cila cenon integritetin apo pastërtinë e figurës. Nuk kam pasur në asnjë rast apo rrethanë kontakte të papërshtatshme në formën e një takimi, komunikimi elektronik, ose çfarëdolloj mënyre takimi të qëllimshëm, me një ose më shumë persona të përfshirë në krimin e organizuar gjatë viteve 2017, 2018 dhe 2019; nuk kam pasur kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar gjatë viteve 2017, 2018 dhe 2019. Për të dhënë më shumë argumente në lidhje me këtë moment, duhet të njihem me aktin konkret të organeve përkatëse lidhur me përfshirjen në veprimtari të dyshimta. Pa parë këtë akt nuk mund të them asgjë më tepër se sa ajo që kam deklaruar si më sipër”.*

⁵⁷Shkresa nr. *** prot., datë 7.10.2019.

⁵⁸Shkresa nr. *** prot., datë 7.10.2019.

Konkluzioni i Komisionit për vlerësimin e kontrollit të figurës

51. Duke e konsideruar procesin e rivlerësimit një proces kushtetues që, megjithëse përfshin edhe kufizimin e të drejtave të subjekteve të rivlerësimit, kërkohet që gjithnjë duhet të kryhet në përputhje me parimin e proporcionalitetit dhe objektivitetit, raporti për subjektin e rivlerësimit duhet të jetë konkret, sa më i qartë, mbështetur në të dhëna të sakta, që provojnë lidhjet e subjektit të rivlerësimit me persona të përfshirë në krimin e organizuar, lidhje këto që mund ta bëjnë edhe subjektin e rivlerësimit lehtësisht të ndikueshëm prej tij.

51.1. Në lidhje me konstatimin e DSIK-së për përfshirje të subjektit në veprime korruptive, Komisioni vlerëson se nga studimi i materialeve të dosjeve të administruara konstatohen shkelje profesionale, të cilat provojnë mangësi të formimit profesional të subjektit për të cilat me vendim të datës 24.7.2020 vendosi: *“Pezullimin nga detyra për një periudhë 1-vjeçare të subjektit të rivlerësimit Artan Çupi, gjyqtar/kryetar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Mat, dhe detyrimin e tij për të ndjekur programin e trajnimit, sipas kurrikulave të miratuara nga Shkolla e Magjistraturës”*, por këto mangësi nuk provojnë dyshimet për korrupsion.

51.2. Në përputhje me parimin e objektivitetit, raporti për subjektin e rivlerësimit duhet të jetë konkret, sa më i qartë, mbështetur në të dhëna të sakta, që provojnë lidhjet e subjektit të rivlerësimit me persona të përfshirë në krimin e organizuar, lidhje këto që mund ta bëjnë edhe subjektin e rivlerësimit lehtësisht të ndikueshëm prej tij, ndërsa në raportin e DSIK-së nuk ka asnjë shpjegim, se cila është prova/ngjarja që provon se subjekti i rivlerësimit i kishte kryer veprimet korruptive, por grupi i punës ka mbetur vetëm në nivelin e dyshimeve, në kundërshtim me detyrën që i ka ngarkuar neni 39 i ligjit nr. 84/2016.

51.3. Trupi gjykues i Komisionit, në analizë të situatës faktike si më sipër, në raport me nenet 34 dhe 38, pikat 4 dhe 5 të ligjit nr. 84/201652, vlerëson se informacioni i përcjellë nga DSIK-ja në raportet e deklasifikuara për subjektin e rivlerësimit nuk përmban elementet e parashikuara nga neni 38 i ligjit nr. 84/2016, pasi nuk referon në asnjë moment se cilët janë personat e përfshirë në krimin e organizuar, me të cilët subjekti ka pasur kontakte të tilla që të ketë shkëmbyer para, favore, dhurata ose pasuri.

51.4. Në përputhje me parimin e objektivitetit, raporti i DSIK-së për subjektin e rivlerësimit duhet të ishte konkret, sa më i qartë, mbështetur në të dhëna të sakta, që provojnë lidhjet e subjektit të rivlerësimit me persona të përfshirë në krimin e organizuar, lidhje këto që mund ta bëjnë edhe subjektin e rivlerësimit lehtësisht të ndikueshëm prej tij. Në këto kushte, trupi gjykues vlerëson se rrethanat e analizuara nuk plotësojnë gjithashtu as rrethanat që merren parasysh në konstatimin se ekziston një kontakt i papërshtatshëm i subjektit të rivlerësimit me një person të përfshirë në krimin e organizuar, të parashikuar nga pikat 4 dhe 5, të nenit 38, të ligjit nr. 84/2016. Për pasojë, trupi gjykues arrin në përfundimin se konkluzioni i DSIK-së, se subjekti i rivlerësimit rezulton i papërshtatshëm në lidhje me kriterin e kontrollit të figurës, nuk është i drejtë.

51.5. Komisioni vlerëson se nuk u provua në ndonjë formë që subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar apo të jetë personalisht i përfshirë. Në përfundim të hetimit administrativ, Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit Artan Çupi ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas parashikimit të germës “b”, të nenit 59/1, të ligjit nr. 84/2016.

C. RIVLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

52. Në lidhje me këtë kriter, Komisioni u shpreh me vendimin e ndërmjetëm nr. 5, datë 24.7.2020.

52.1. Pas analizimit të detajuar të dosjeve të administruara qoftë në kuadrin e vlerësimit profesional, qoftë në kuadrin e vlerësimit të figurës, Komisioni konstatoi mangësi profesionale, të cilat mund të plotësoheshin nëpërmjet ndjekjes së programit të trajnimit njëvjeçar të Shkollës së Magjistraturës.

52.2. Në përfundim të këtij trajnimi, me shkresën nr. *** prot., datë 16.7.2021, Shkolla e Magjistraturës ka dërguar në Komision rezultatet e provimit përfundimtar të subjektit, bazuar në pikën 2 të nenit 60 të ligjit nr. 84/2016.

52.3. Bazuar në rezultatet e arritura, të miratuara nga Këshilli Pedagogjik si dhe Këshilli Drejtues i Shkollës së Magjistraturës, me vendimin nr. ***, datë 15.7.2021, konstatohet se subjekti i rivlerësimit Artan Çupi ka arritur rezultate të mira, duke i kaluar mangësitë e parashtruara në vendimin e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

KONKLUZIONI PËRFUNDIMTAR

53. Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, dëgjoi subjektin e rivlerësimit në seancën dëgjimore publike, si dhe mori në shqyrtim të gjitha pretendimet dhe provat e parashtruara, konstaton se:

1. subjekti arrin nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë;
2. subjekti arrin nivel të besueshëm në kontrollin e figurës; dhe
3. subjekti, bazuar në shkresën e Shkollës së Magjistraturës, rezulton se ka përfunduar me sukses programin e trajnimit, duke mënjanuar mangësitë e konstatuara nga Komisioni.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, në bazë të nenit 58, pika 1, germa “a”, nenit 59, pika 1 dhe të nenit 60, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, me shumicë votash,

V E N D O S I:

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Artan Çupi, gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Mat.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, i njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë brenda 30 ditëve pas përfundimit të seancës dëgjimore dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.

3. Ky vendim ankimohet pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

U shpall në Tiranë, në datën 16.9.2021.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Genta Tafa (BUNGO)

Kryesuese

Etleda ÇIFTJA
Relatore (kundër)

Pamela QIRKO
Anëtare

Olsida Goxhaj
Sekretare gjyqësore

